



MedMPAnet^{project}

SHQIPËRIA DHE ZONAT E MBROJTURA DETARE

VLERËSIMI I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR RUAJTJEN
E BIODIVERSITETIT BREGDETAR DHE DETAR DHE KRIJIMIN
E ZMD-VE



Shqipëria dhe zonat e mbrojtura detare

Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit bregdetar dhe detar dhe krijimin e ZMD-ve

2014

Ky dokument u hartua nga:

UNEP/MAP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin / Plani i Veprimit për Mesdheun

RAC/SPA – Qendra Rajonale e Veprimtarive për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

UNEP/MAP – United Nations Environment Programme / Mediterranean Action Plan

RAC/SPA – Regional Activity Centre for Specially Protected Areas

Regional Activity Centre for Specially Protected Areas (RAC/SPA)

Boulevard du Leader Yasser Arafat

B.P. 337, 1080 Tunis Cedex, Tunizi

Telefoni: +216 71 206 649 / 71 206 485 / 71 206 765

Faksi: +216 71 206 490

www.rac-spa.org

Dhe

IUCN-Med: IUCN Qendra për Bashkëpunimin në Mesdhe:

IUCN-Med: International Union for Conservation of Nature - Centre for Mediterranean Cooperation

IUCN Centre for Mediterranean Cooperation

C/ Marie Curie 22

29590 Campanillas, Malaga, Spanjë

Telefoni: +34 952 028430

Faksi: +34 952 028145

www.iucn.org/mediterranean

IUCN ELC: IUCN-Qendra për të Drejtën Mjedisore

IUCN ELC: IUCN Environmental Law Centre

Godesberger Allee 108-112

53175 Bon, Gjermani

Telefoni: ++49 - 228 - 2692 - 231

Faksi: ++49 - 228 - 2692 - 250

ELCsecretariat@iucn.org

Në kuadrin e:

Projektit MedMPAnet – Projekti Rajonal për Zhvillimin e Rrjetit Mesdhetar të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare nëpërmjet nxitjes së Krijimit dhe Menaxhimit të ZMD-ve (<http://medmpanet.rac-spa.org/>)

The designation of geographical entities in this book, and the presentation of the material, do not imply the expression of any opinion whatsoever on the part of UNEP/MAP-RAC/SPA, IUCN, or the MAVA Foundation concerning the legal status of any country, territory, or area, or of its authorities, or concerning the delimitation of its frontiers or boundaries.

The views expressed in this publication do not necessarily reflect those of UNEP/MAP-RAC/SPA, IUCN, or the MAVA Foundation.

Reproduction of this publication for educational or other non-commercial purposes is authorized without prior written permission from the copyright holder provided the source is fully acknowledged.

Reproduction of this publication for resale or other commercial purposes is prohibited without prior written permission of the copyright holder.

Published by: RAC/SPA and IUCN-Med.

Copyright: © 2014 – RAC/SPA and IUCN-Med.

Citation: *Shqipëria dhe zonat e mbrojtura detare: Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit bregdetar dhe detar dhe krijimin e ZMD-ve*. RAC/SPA and IUCN-Med. Ed. RAC/SPA - MedMPAnet Project, Tunis. 48pp.

Editor:

François-Xavier Bouillon,

F-06800 Cagnes-sur-Mer.

Mbledhja e të dhënave bazë nga Faidra Bazigou, Konsulente.

Përkthyer në shqip nga Esmeralda Subashi.

Cover Layout: Zine El Abidine MAHJOUR.

Cover photo: © INCA.

Available from:

UNEP/MAP-RAC/SPA: www.rac-spa.org

IUCN-Med: www.iucn.org/mediterranean

Treguesi

Lista e akronimeve	4	II. Projektet në vazhdim dhe krijimi i rrjeteve	22
Falënderime	5	A. Projektet ndërkombëtare	22
Hyrje	7	B. Krijimi i rrjeteve	23
Konteksti shqiptar	9		
Qasja metodologjike	11		
		PJESA III – KOMENTE DHE REKOMANDIME	
PJESA I – KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL		PËR ZONAT E MBROJTURA DETARE	
PËR ZONAT E MBROJTURA DETARE		NË SHQIPËRI	25
NË SHQIPËRI	14	I. Komente dhe rekomandime të përgjithshme	25
I. Kuadri ligjor dhe ai i politikave		A. Legjislacioni dhe politikat	25
për Zonat e Mbrojtura Detare	14	B. Institucionet	27
A. Instrumentet ligjore për ZMD-të	14	C. Menaxhimi	27
B. Instrumente të tjera të rëndësishme	14	D. Qasja e shumë grupeve të interesit	28
C. Kuadri i politikave për ZMD-të	16		
II. Rregullimet institucionale		II. Komente dhe rekomandime të veçanta	28
për Zonat e Mbrojtura Detare	17	A. SKPVB-ja	28
A. Organet qeverisëse të ZM-ve	17	B. A nevojitet një VNM dhe VSM	
III. Qeverisja dhe menaxhimi i posaçëm		për shpalljen e ZMD-së?	28
i Zonave të Mbrojtura Detare	19	C. Burimet e financimit të ZMD-ve	29
A. Qeverisja	19		
B. Menaxhimi	19		
C. Financimi	20		
		LISTA E SHTOJCAVE	
PJESA II – ANALIZA E GRUPEVE TË INTERESIT		Shtojca I – Konventat Ndërkombëtare dhe Marrëveshjet	
PËR ZONAT E MBROJTURA DETARE		Shumëpalëshe të ratifikuara nga Shqipëria me interes	
NË SHQIPËRI	21	për Zonat e Mbrojtura Detare	30
I. Grupe të tjera të rëndësishme të interesuara		Shtojca II – Raporti i Takimi Kombëtar të Punës për ZMD-të	
për ruajtjen e mjedisit detar	21	i organizuar në Tiranë, Shqipëri në korrik 2013	
A. Institutet akademike dhe kërkimore		(i disponueshëm vetëm në gjuhën angleze)	32
në fushën e mjedisit detar	21	Shtojca III – Përkufizimi dhe kategoritë e menaxhimit	
B. OJF-të	21	të IUCN-së për ZMD-të.....	43
C. Publiku	22	Shtojca IV – Rast studimi, FMM-ja në Egjipt	45

LISTA E AKRONIMEVE

ACCOBAMS/MRCDZDM	Marrëveshja për Ruajtjen e Cetaceve në Detin e Zi dhe Detin Mesdhe
APAWA/SHMGJUSH	Shoqata e Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë
AEWA/SHAZSHU	Shpendët Afro-Aziatikë Shtegtarë të Ujit
CBD/KDB	Konventa për Diversitetin Biologjik
CEMSA/KSMMSH	Konsolidimi i Sistemit të Monitorimit të Mjedisit në Shqipëri
CITES/KTNLLRR	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara
CPA/ZMB	Zonat e Mbrojtura Bregdetare
EEA/AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
EIA/VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
EIONET/RREMI	Rrjeti Evropian Mjedisor i Vëzhgimit dhe Informimit
EU/BE	Bashkimi Evropian
GEF/FGM	Faciliteti Global Mjedisor
IMOC/QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
INCA/IRNSH	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (OJQ)
IPE/IMM	Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit
IUCN/UNRN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
LEPLMM	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
LBP/LMB	Ligji për Mbrojtjen e Biodiversitetit
LF(A)/LP(A)	Ligji për Peshkimin (dhe Akuakulturën)
LPA/LZM	Ligji për Zonat e Mbrojtura
LPPD/LMMDND	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Dëmtimet
MPA/ZMD	Zonë e Mbrojtur Detare
MoEFWA/MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
NFO/OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
NBSAP/SKPVB	Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin
NEA/AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
NGO/OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
PA/ZM	Zonë e Mbrojtur
PPNEA/MRMNSH	Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri (OJQ)
RAMSAR/KRLRN	Konventa për ruajtjen e e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare
REA/ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
SEA/VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
SELEA/MZLMSH	Mbështetje për Zbatimin e Ligjit për Mjedisit në Shqipëri
SP/MCPA/PSZMDB	Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare
UNESCO/OKBASHK	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën e Kulturën
UNDP/PKBZH	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Falënderime

Ky dokument, i titulluar *“Shqipëria dhe Zonat e Mbrojtura Detare: Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit bregdetar dhe detar dhe krijimin e ZMD-ve 2013”* është rezultat i një procesi bashkëpunimi që nisi në fillim të vitit 2012. Puna përkatëse përfshiu konsultime zyrtare dhe jozyrtare, një takim kombëtar pune, si edhe rishikime të drafteve të njëpasnjëshme nga profesionistët e fushës dhe ekspertët.

Falënderimet tona së pari shkojnë për **Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë** dhe në veçanti për Prof. Dr. Pëllumb Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm i Mjedisit, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të tij.

Gjithashtu u përcjellim falënderimet tona Z. Zamir Dedej dhe Z. Genti Kromidha të Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (**INCA**), për ndihmën e tyre në veçanti në lidhje me organizimin e takimit kombëtar të konsultimit dhe rishikimit të këtij raporti.

Teksa ky studim u bashkërendua nga UNEP/MAP RAC/SPA, IUCN-Med dhe IUCN ELC, ai u bë i mundur falë projektit MedMPANet, i mbështetur nga Komisioni Evropian, Agjencia Spanjolle për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (AECID) si edhe nga Faciliteti Global Mjedisor Francez (FFEM).

Mbledhja e të dhënave paraprake u realizua në kuadrin e projektit NEREUS, i financuar nga Fondacioni MAVA, në bashkëpunim me Nismën për Ligatinat Mesdhetare (MedWET).

Në korrik 2013, në Tiranë u organizua një takim kombëtar konsultimi, nga i cili dolën komente dhe kontribute të vlefshme për draftin e parë të punës të Vlerësimit të Kuadrit Ligjor dhe Institucional. Prandaj, institucionet dhe organizatat e mëposhtme meritojnë falënderime të veçanta:

- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU)
- Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri
- Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), Durrës
- Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, Shkodër

— Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

— Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

— Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)

— Programi i IUCN-së për Evropën Juglindore, Shqipëri

— Universiteti Bujqësor i Tiranës

— Projekti “Ruajtja dhe Përdorimi i Qëndrueshëm i Biodiversitetit në Liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës”, GIZ

— Projekti i PNUD-it për ZMD-të, Vlorë

— Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë

Mirënjohje e veçantë shkon për Znj. Faidra Bazigou e cila bëri hulumtimet bibliografike dhe siguroi materialin bazë ligjor.

Gjatë kalimit nga drafti përfundimtar në publikim, detyrat kryesore u realizuan nga konsulentët e pavarur. Znj. Jill Harry, e Deadline SARL siguroi cilësinë e gjuhës në anglisht ndërsa Znj. Esmeralda Subashi, bëri përkthimin për botimin në gjuhën shqipe. Z. François-Xavier Bouillon, me profesionalizmin që e karakterizon, bashkërendoi publikimin dhe punoi me dizenjimin dhe faqosjen e tij.

Shpresojmë që ky raport do ta ndihmojë Shqipërinë në zhvillimin dhe përmirësimin e instrumenteve ligjore dhe strategjike të saj për ZMD-të.



Porto Palermo © INCA.

Hyrje

Projekti Rajonal për Zhvillimin e një Rrjeti Mesdhetar për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare nëpërmjet nxitjes së Krijimit dhe Menaxhimit të ZMD-ve “Projekti MedMPAnet” (<http://medmpanet.rac-spa.org>) është një program pesë-vjeçar (2010-2015) i zbatuar nga Qendra Rajonale e Veprimtarive për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (RAC/SPA – UNEP/MAP; www.rac-spa.org) si pjesë e Partneritetit Strategjik për Ekosistemin e Madh të Detit Mesdhe “MedPartnership” (www.themedpartnership.org). Nënkomponenti 3.1: Ruajtja e diversitetit detar dhe bregdetar nëpërmjet zhvillimit të një rrjeti mesdhetar të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare.

Projekti MedMPAnet merret kryesisht me proceset që çojnë në krijimin e zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare (ZMD) në disa vende mesdhetare (Algjeri, Shqipëri, Kroaci, Egjipt, Liban, Mali i Zi, Marok, Tunizi). Procesi i krijimit të ZMD-ve në përgjithësi kalon nëpër hapat e mëposhtme: (i) Vlerësimi i kuadrit Ligjor dhe Institucional për ruajtjen e biodiversitetit detar dhe bregdetar (ii) studimet ekologjike, (iii) studimet social-ekonomike dhe të peshkimit, (iv) planifikimi i menaxhimit (v) shtjellimi i pjesëmarrjes së grupeve të interesit dhe mekanizmave të angazhimit, dhe (vi) zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshme të financimit. Këto veprimtari shoqërohen me mbështetje teknike për përmirësimin e menaxhimit të ZMD-ve dhe ngritjen e kapaciteteve të menaxherëve profesionistëve të ZMD-ve.

Në Shqipëri partnerja e projektit MedMPAnet është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Në këtë kontekst, RAC/SPA nënshkroi në vitin 2012 një memorandum Mirëkuptimi me Qendrën për Bashkëpunim në Mesdhe të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN-Med) duke pasur parasysh që:

1. Duhej bërë një vlerësim gjithëpërfshirës i kuadrit ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit detar dhe bregdetar dhe krijimin e zonave të mbrojtura në rajonin e detit Adriatik;
2. Analiza dhe rekomandimet e kuadrit ligjor dhe institucional për zonat e mbrojtura detare do të kontribuonin në ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit detar si edhe të burimeve të tjera natyrore që përbënin pasuritë e biodiversitetit të detit Adriatik.

Memorandumi i Mirëkuptimit identifikoi kështu si veprimtari “vlerësimin dhe mbështetjen e nevojave prioritare për reforma ligjore, politike dhe institucionale të vendeve të Adriatikut me qëllim forcimin e proceseve të krijimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura detare”.

Ky dokument i titulluar “Shqipëria dhe Zonat e Mbrojtura Detare: Vlerësimi i kuadrit Ligjor dhe Institucional për ruajtjen e biodiversitetit detar dhe bregdetar dhe krijimin e ZMD-ve” është rezultati i veprimtarisë së sipërpërmendur në vend.

1 <http://www.unepmap.org/index.php?module=content2&catid=001015>



Gjiri i Himarës © INCA.

Konteksti shqiptar

Republika e Shqipërisë është një vend i Evropës Juglindore. Ajo kufizohet me Malin e Zi në Veriperëndim, Kosovën në Verilindje, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në lindje dhe Greqinë në jug dhe juglindje. Shqipëria paraqiti kërkesën zyrtare për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian më 28 prill 2009.

Shqipëria ka një vijë bregdetare 427 km të gjatë: 273 km në perëndim në detin Adriatik dhe 154 km në jugperëndim në detin Jon. Ujërat e brendshme përbëjnë km² dhe ujërat territoriale (që zgjaten nga ujërat e brendshme deri në 12 milje detare nga bregu) përbëjnë 5,322 km². Totali është rreth 6,000 km², dhe vendi duhet të deklarojë 600 km² për të përmbushur me 10% kërkesën për ZMD-të të Konventës për Diversitetin Biologjik (synimet e Aichi-t, 2012).

Ekosistemet detare dhe ligatinat bregdetare të Shqipërisë janë të pasura me tipologji habitatesh dhe biodiversitetin shoqëruar. Ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë natyrore jo vetëm për vendin por gjithashtu edhe për rajonin e Mesdheut në tërësi.

Ruajtja e natyrës në Shqipëri filloi rreth 50 vjet më parë, por mori zhvillim më të fuqishëm pas vitit 1990. Aktualisht në Shqipëri janë rreth 799 zona të mbrojtura, ku përfshihen 750 monumente natyrore, që mbulojnë afërsisht 16% të sipërfaqes totale tokësore të vendit.²

Pavarësisht nga vija e gjatë bregdetare dhe roli i rëndësishëm i ekosistemit detar në natyrën dhe biodiversitetin, historinë, kulturën, turizmin dhe socio-ekonominë e vendit në përgjithësi, në Shqipëri nuk ishin krijuar zona të mbrojtura detare deri në vitin 2010. Zonat e mbrojtura bregdetare ekzistuese, ku përfshihen kryesisht lagunat bregdetare, grykat e lumenjve dhe deltat, supozohet se nënkuptojnë edhe habitatet detare ngjitur me to, ndonëse këto habitate asnjëherë nuk janë emërtuar dhe menaxhuar si ZMD³.

Kohët e fundit, në Shqipëri janë zhvilluar kërkime detare, duke rritur ndërgjegjësimin për ZMD-të dhe ruajtjen e mjedisit detar⁴. ZMD-ja e parë e shpallur ishte ajo e Ishullit të Sazanit – Gadishullit të Karaburunit më 28 prill 2010, me statusin e Parkut Kombëtar Detar (IUCN kategoria II) që mbulon një sipërfaqe prej 12.570 ha, (rreth 2% e ujërave territoriale). Zona të tjera janë propozuar si ZMD potenciale, së pari në vitin 1999 nga Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (NEA/AKM 1999), më shumë kohët e fundit, në vitin 2013 nga Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe bregdetare (INCA/IRNSH, MMPAU, zyra e PNUD-it në Shqipëri).

Më poshtë identifikohen dhe renditen kërcënimet kryesore ndaj mjedisit detar dhe bregdetar: zhvillimi i pakontrolluar urban dhe ai i turizmit; rritja e ndotjes veçanërisht për shkak të shkarkimit në det të mbetjeve të patrajtuara dhe ujërave të zeza; shpyllëzimi dhe erozioni; niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut në lidhje me çështjet e mjedisit detar dhe bregdetar; ndërhyrjet abuzive në shtretërit e lumenjve dhe basenet ujore; bonifikimi i paqëndrueshëm i tokës në ligatinat bregdetare; peshkimi dhe gjuetia e paligjshme; si edhe peshkimi dhe akuakultura e paqëndrueshme.

2 Ministria e Mjedisit: www.moe.gov.al.

3 VARSTVO NARAVE, Supl. 1(2011)

4 VARSTVO NARAVE, Supl. 1(2011)



ZMD-ja e Karaburunit © INCA.

Qasja metodike

Qasja metodike e përdorur për hartimin e këtij dokumenti është përcaktuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet RAC/SPA dhe zyrës së IUCN-Med në vitin 2012.

Sipas kësaj marrëveshjeje, IUCN-Med mblodhi të gjithë informacionin e disponueshëm dhe legjislacionin nëpërmjet hulumtimeve bibliografike, intervistave me grupet kombëtare të interesit dhe konsultimeve në Shqipëri.

Pyetësi i mëposhtëm u përgatit nga IUCN ELC⁵. Ai u përdor si një instrument për të drejtuar vlerësimin e kuadrit ligjor, politik dhe institucional në lidhje me ZMD-të në Shqipëri.

Çështjet për t'u vlerësuar	
Kuadri Ligjor i Përgjithshëm i Zonave të Mbrojtura Detare	
1	Jepni një vështrim të përgjithshëm të vendit (situata ekonomike, gjendja e burimeve natyrore dhe ekosistemeve, sipërfaqja e mbuluar nga sistemi kombëtar i ZMD-ve, etj.)
2	Cilat janë instrumentet ligjore parësore të zonave të mbrojtura? <ul style="list-style-type: none"> • Jepni titullin e plotë të çdo instrumenti (nëse ka më shumë se një) dhe vitin kur është miratuar apo nxjerrë. • A e rregullon instrumenti ligjor të gjithë sistemin e zonave të mbrojtura (zonat e mbrojtura tokësore dhe detare), apo ka një instrument specifik për sistemin e ZMD-ve, jepni shpjegime.
3	Identifikoni në ç'nivel të qeverisjes është miratuar instrumenti (parlamenti i vendit, nivel ministror etj.)
4	Identifikoni Ministrin apo organe të tjera të nivelit politik me kompetenca të plota për zbatimin e instrumentit të zonave të mbrojtura.
5	Identifikoni agjencitë/departamentet e specializuara në zonat e mbrojtura për gjegjëse për zbatimin/mbikëqyrjen çdo ditë të sistemit të zonave të mbrojtura (zona të mbrojtura tokësore dhe detare ose vetëm ZMD).
Fusha e zbatimit e kuadrit ligjor	
6	A i njeht kuadri ligjor për sistemin e ZM-ve alternativat e mëposhtme të qeverisjes dhe menaxhimit? <ul style="list-style-type: none"> • Qasje e centralizuar ku zona e mbrojtur është tërësisht pronë shtetërore dhe menaxhohet nga qeveria në nivel kombëtar; • Qasje e decentralizuar ku menaxhimi i tokës publike mund t'u delegohet njësitë të qeverisjes provinciale, shtetërore apo vendore; • Partneritet publik/privat nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëmenaxhimi ndërmjet qeverisë dhe aktorëve të tjerë, duke përfshirë edhe komunitetet; • Menaxhim privat: zonat e mbrojtura zotërohen dhe menaxhohen në mënyrë vullnetare nga subjekte të sektorit privat (Zonat e Mbrojtura Private, (fitimprurëse dhe jo-fitimprurëse); • Menaxhim nga vendasit dhe komunitetet lokale.

⁵ Lausche, Barbara. (2011). *Udhëzime për legjislacionin e zonave të mbrojtura*. IUCN, Gland, Zvicër. xxvi + 370 pp.

Politika e ZMD-ve	
7	A identifikon instrumenti ligjor një politikë, synime dhe objektiva për ZMD-të në bazë të të cilave zona(t) duhet të krijohen dhe menaxhohen; jepni shpjegime.
8	A ka dokumente politikash të referuara në instrumentin ligjor si pjesë e kuadrit të politikave për sistemin apo vendin- p.sh. strategjia kombëtare për biodiversitetin; strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm, etj.? Specifikoni.
9	A ka dispozita ligjore në sistemin e ZM-ve që u referohen angazhimeve të tjera ligjore ndërkombëtare (p.sh. KDB-së) apo marrëveshje rajonale (p.sh. Konventa e Barcelonës) si politika dhe objektiva për sistemin e ZM-ve? Nëse po, jepni sqarime.
10	A i përfshin sistemi i ZM-ve parimet e mëposhtme ndërkombëtare mjedisore? <ul style="list-style-type: none"> • Parimin e parandalimit dhe marrjes së masave paraprake. • Pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin ndaj informacionit. A parashikojnë instrumenti ligjor apo praktika të tjera ligjore apo administrative për zonat e mbrojtura konsultimin me publikun, aksesin ndaj informacionit, të drejtën për të rishikuar propozimet për krijimin e zonave të mbrojtura? • Njohja e komuniteteve lokale dhe banorëve vendas (indigjenëve). A ka dispozita politikash të veçanta për njohjen e të drejtave apo statusit të komuniteteve lokale apo, në vendet ku kjo zbatohet, të drejtat e banorëve vendas (indigjenëve)? • Vlerat kulturore.
Objektivat	
11	A i shpreh instrumenti ligjor qartë objektivat për sistemin e zonave të mbrojtura, nëse po, jepni formulimin.
12	Tregoni nëse shprehet qartë (në mënyrë eksplicite) që objektivi parësor i zonave të mbrojtura është ruajtja e tyre, nëse po, jepni formulimin.
Përkufizimet	
13	A ekziston në instrumentin ligjor përkufizimi i termit "zonë e mbrojtur"; nëse po jepni përkufizimin. <ul style="list-style-type: none"> • A është ky përkufizim në përputhje me përkufizimin e IUCN-së?⁶ • A është përkufizuar termi "zonë e mbrojtur detare" në instrumentin ligjor; nëse po jepni përkufizimin.
14	A përcakton instrumenti ligjor kategori të ndryshme të menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas objektivit të ruajtjes (parqe kombëtare, ZMD, zonat e ruajtjes së habitateve, zona kulturore, etj.) dhe nëse po jepni formulimin. <ul style="list-style-type: none"> • A janë zbatuar kategoritë e menaxhimit të përcaktuara nga IUCN-ja për ZMD-të; jepni shpjegime.
Rregullime institucionale	
15	Kush e ka autoritetin për të krijuar ZMD-të, a është identifikuar ai autoritet në instrumentin ligjor; jepni shpjegime.
16	A parashikon instrumenti ligjor subjekte të tjera përgjegjëse për funksionet e menaxhimit? Nëse po, jepni hollësi. A janë parashikuar mekanizma për bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet agjencive kryesore qeveritare përgjegjëse për çështjet detare (p.sh. ruajtjen e mjedisit detar, peshkimin, transportin me anije, doganat, etj.); jepni shpjegime.
17	A janë parashikuar mekanizma për bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet agjencive kryesore qeveritare përgjegjëse për çështjet detare (p.sh. ruajtjen e mjedisit detar, peshkimin, transportin me anije, doganat etj.); jepni shpjegime.



© RAC/SPA, Yassine Ramzi Sghaier.

6 Një zonë e mbrojtur është një hapësirë gjeografike e përcaktuar qartë, e njohur, dedikuar dhe menaxhuar nëpërmjet mjeteve ligjore apo instrumenteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen afatgjatë të natyrës me shërbimet shoqëruese të ekosistemit dhe vlerave kulturore (Përkufizimi i IUCN-së 2008).

Planifikimi i Sistemit të ZMD-ve	
18	<p>A kërkon kuadri ligjor për ZMD-të hartimin e një plani për sistemin e zonave të mbrojtura për të drejtuar zhvillimin dhe menaxhimin e tij? Nëse po, ju lutemi tregoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë qëllimet kryesore dhe përmbajtja e një plani? • Kush apo cili subjekt është përgjegjës për hartimin, mirëmbajtjen dhe zbatimin e planit? • Cilat janë elementet kyç që duhet të merren parasysh kur një sistemi i shtohen zona të reja të mbrojtura (p.sh. përfaqësueshmëria, unikaliteti, përputhja me kërkesat ndërkombëtare, mbështetja e proceseve themelore ekologjike apo biodiversiteti etj.) • A ka një kërkesë për rishikim dhe vlerësim periodik të planit të sistemit në drejtim të qëllimeve dhe objektivave të përgjithshme të sistemit të zonës së mbrojtur; jepni shpjegime.
19	<p>A autorizon apo parashikon kuadri ligjor për zonat e mbrojtura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zonimin, • zonat e ndalimit të shfrytëzimit, • zonat rreptësisht të mbrojtura, • kërkimin shkencor në det me leje, • monitorimin e mjedisit.
20	<p>A ka kërkesa të veçanta se si përcaktohen kufijtë e një zone detare në tërësi dhe zonat brenda saj; a ka kërkesa për konsultimin me grupet e interesit apo komunitetin vendas në caktimin e kufijve; jepni shpjegime.</p>
21	<p>A ka dispozita që autorizojnë caktimin e "zonave buferike" për zonat e mbrojtura detare apo korridore ruajtjeje ndërmjet zonave detare; jepni shpjegime.</p>
Krijimi, amendimi dhe shfuqizimi i ZMD-ve	
22	<p>Kush e ka autoritetin për të krijuar, amenduar dhe shfuqizuar një zonë të mbrojtur? A i ka të gjitha këto kompetenca i njëjti autoritet? Nëse i njëjti autoritet nuk i ka të tria kompetencat, identifikoni cili është autoriteti për secilën kompetencë, dhe jepni shpjegime për se këto kompetenca janë ndarë ndërmjet autoriteteve të ndryshme.</p>
23	<p>Cila është procedura që ndiqet për krijimin, amendimin dhe shfuqizimin e një zone të mbrojtur?</p>
Financimi	
24	<p>A autorizon kuadri ligjor i zonës së mbrojtur instrumente të veçanta financimi për sistemin e zonave të mbrojtura detare?</p>
Plani i Menaxhimit	
25	<p>A ka kërkesë për një plan menaxhimi; nëse po, përshkruani dispozitat përkatëse duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dispozitat për përmbajtjen e kërkuar të planit, mundësinë e zonimit për klasifikime të ndryshme dhe qëllime ruajtjeje • procedurat për hartimin e planit (qarkullimi dhe konsultimi ndërmjet organeve shkencore dhe teknike brenda dhe jashtë qeverisë; kërkesat dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit) • Autoriteti (autoritetet) përgjegjëse për zbatimin e menaxhimit (marrëveshje bashkëmenaxhimi me autoritete të tjera)
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM-ja)	
26	<p>A kërkon kuadri ligjor i zonave të mbrojtura VNM për një projekt apo veprimtari të propozuar, publike apo private, ku mund të ketë ndikime të konsiderueshme mjedisore në zonën e mbrojtur, dhe nëse po, shpjegoni, duke përfshirë procedurat apo kërkesat e veçanta që mund të specifikohen, duke përfshirë përgatitjen, rishikimin, komentet e publikut, autoritetin vendimmarrës dhe ankimin.</p>
Të tjera	
27	<p>Nëse është e zbatueshme, identifikoni dhe diskutoni në lidhje me instrumente të tjera ligjore (p.sh. në peshkim, turizëm etj.) të cilat parashikojnë kompetenca për forma të caktuara mbrojtjeje, të pjesshme apo të plotë, të vendeve, ekosistemeve apo habitateve të llojeve të veçanta; tregoni ndikimin e tyre të mundshëm mbi kuadrin ligjor të zonave të mbrojtura dhe, sipas rastit, si janë apo duhen harmonizuar, bëhen pjesë e rrjeteve apo bashkërenduar instrumentet e ndryshme.</p> <p>Tregoni karakteristika të tjera të veçanta unike për kuadrin ligjor të ZMD-ve, p.sh. pjesë e një projekti të madh për ekosistemin detar, pjesë e një zonë të mbrojtur detare ndërkufitare, mbrojtje e llojeve të veçanta, status i veçantë sipas së drejtës ndërkombëtare (p.sh., IMO, Vendet e Trashëgimisë Botërore, etj.).</p>

Rezultatet e kësaj metodologjie kaq të avancuar u paraqitën së bashku me një vlerësim paraprak gjatë një takimi (workshop) kombëtar pune përmbledhës ku ishin ftuar aktorët kryesorë kombëtarë të identifikimit, shpalljes dhe menaxhimit të ZMD-ve (shihni raportin e takimit në Shtojcën 2). Rishikimi i informacionit të mbledhur deri në atë çast dhe diagnoza e nevojave prioritare ishin objektivat kryesore të këtij takimi kombëtar pune.

Duke u mbështetur në konsultimin në nivel kombëtar, IUCN-Med ishte në gjendje të formulonte rekomandimet (të paraqitura në PJESËN III) për përmirësimin e kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional si edhe në lidhje me disa prioritete të tjera të identifikuara nga vendi.

Pjesa I

Kuadri ligjor dhe institucional për zonat e mbrojtura detare në Shqipëri

I. KUADRI LIGJOR DHE AI I POLITIKAVE PËR ZONAT E MBROJTURA DETARE

Në Shqipëri, nuk është hartuar asnjë ligj apo politikë veçanërisht për ZMD-të. Prandaj, ligjet kryesore dhe dokumentet strategjike që zbatohen për zonat e mbrojtura, aplikohen edhe për ZMD-të.

A. Instrumentet ligjore për ZMD-të⁷

Ka dy akte ligjore kryesore që rregullojnë ruajtjen e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri:

— Ligji për “Zonat e Mbrojtura” (Nr. 8906, datë 06.06.2002) i ndryshuar me Ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8906, datë 06.06.2002” (9868 / 04.02.2008).

— Ligji për “Mbrojtjen e Biodiversitetit” (Nr. 9587, datë 20.07.2006).

A.1. Ligji për Zonat e Mbrojtura

Ligji për Zonat e Mbrojtura (Nr. 8906, datë 06.06.2002 i ndryshuar me Ligjin Nr. 9868, 04.02.2008) krijon kuadrin për shpalljen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; dhe krijon bazën e zhvillimit dhe lehtësimit të turizmit mjedisor dhe përfitimeve të tjera ekonomike⁸. Ky ligj, i cili u ndryshua në vitin 2008, ka për qëllim shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre. Sipas ligjit, zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe ripërtëritjen e habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore.

Sipas Ligjit për Zonat e Mbrojtura, gjashtë kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri ndjekin sistemin e kategorive të menaxhimit të IUCN-së (që detajohen më tej në seksionin III).

7 Autorët rekomandojnë gjithashtu edhe leximin e faqeve 122-134 të “Vlerësimi i boshllëqeve të zonave të mbrojtura: biodiversiteti detar dhe legjislacioni për zonat e mbrojtura detare”, i publikuar në vitin 2010 nga MMPAU, PNUD, FGM.

8 Zuna *et al.*, 2010

Ministria e Mjedisit ka për detyrim të formulojë objektivat për monitorimin e zonave të mbrojtura, të drejtojë organizimin dhe realizimin e tyre dhe të përpunojë dhe publikojë rezultatet e monitorimit. Administratat e zonave të mbrojtura caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Së fundmi, në lidhje me informimin e publikut, Neni 13(1) i referohet qasjes pjesëmarrëse në shpalljen e një zone të mbrojtur. Aty thuhet shprehimisht: “pas marrjes së mendimit të organeve të qeverisjes vendore dhe të institucioneve të specializuara, organizatave jo-fitimprurëse dhe të pronarëve privatë, në rast se prona e tyre përfshihet në zonën e mbrojtur”.

A.2. Ligji për Mbrojtjen e Biodiversitetit

Ligji Nr. 9587 për Mbrojtjen e Biodiversitetit (datë 20.07.2006) ka për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e diversitetit/larmisë biologjik(e) nëpërmjet rregullimit të përdorimit të qëndrueshëm të elementeve të tij përmes integritetit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategji, plane, programe dhe të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

Meqë fusha e veprimit e ligjit për biodiversitetin përfshin zonat ujore dhe detare, ai është një instrument i rëndësishëm për krijimin e zonave të mbrojtura detare.

B. Instrumente të tjera të rëndësishme

Përveç ligjeve të sipërpërmendura, instrumente të tjera ligjore janë gjithashtu të rëndësishme për ZMD-të:

— Ligji për “Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Dëmtimi” (Nr. 8905, datë 06.06.2002).

— Ligji për “Peshkimin dhe Akuakulturën” (Nr. 7908, datë 05.03.1995), i rishikuar në vitin 2012 dhe i miratuar si Ligji për “Peshkimin” (Nr. 64/2012 datë 31.05.2012).

— Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 10.431, datë 09.06.2011).

— Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 10.440, datë 07.07.2011).

B.1. Ligji për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi

Ligji Nr. 8905 për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi (datë 06.06.2002) ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotja dhe dëmtimet, nëpërmjet parandalimit dhe shmangies së tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare.

“Mjedisi detar” përkufizohet si (Neni 2.1.):

Hapësira detare e Republikës së Shqipërisë, së bashku me faunën dhe florën, pasuritë e ujit, të sipërfaqes së fundit të detit dhe të nëntokës së tij, duke përfshirë edhe vijën bregdetare, plazhet, portet, radat dhe territoret tokësore të tyre, lagunat, grykëderdhjet e lumenjve, liqenet e vijës së ujit, që komunikojnë me detin.

Mbrojtja e mjedisit detar është objekt i të gjitha ligjeve për mjedisin dhe akteve nënligjore të Republikës së Shqipërisë dhe konventave, protokolleve, marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Pastërtia e mjedisit detar, mbrojtja e tij nga ndotja dhe dëmtimet është detyrë e strukturave të qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve.

Ligji përshkruan shumë veprimtari të ndaluara ndërsa kontrolli i mjedisit detar dhe i veprimtarive që zhvillohen në të ushtrohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit, nga kapiteneritë e porteve, nga organet shtetërore që kanë licencuar veprimtaritë, si dhe nga organe të tjera të përcaktuara me ligj.

Kontrolli i kushteve dhe cilësisë së mjedisit detar për të vëzhguar e regjistruar ndryshimet e tyre është i përhershëm dhe i vazhdueshëm. Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit kontrollon ndikimet e veprimtarive në mjedisin detar, si i zbatojnë ato kërkesat e legjisllacionit mjedisor dhe kushtet e vëna në lejen mjedisore. Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit bashkërendon punën me kapiteneritë e porteve, me Inspektoratin e Peshkimit, me Policinë e Shtetit, si dhe me Rojat Bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

B.2. Ligji për Peshkimin

Ligji për “Peshkimin dhe Akuakulturën” (Nr. 7908, datë 05.04.1995) zbatohet për veprimtaritë e peshkimit dhe akuakulturës të zhvilluara në ujërat dhe territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai u ndryshua me Ligjet Nr. 8763/2001, Nr. 8870/2002 dhe Nr. 10.001/2008. Së fundmi, u hartua dhe miratua një ligj i ri i quajtur “Ligji për Peshkimin” (64/2012, 31.05.2012) (LP). Ligji u përgjigjet qartë kërkesave të rregullores 1967/2006 (21.12.2006) të KE-së në lidhje me masat e menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkimit në Detin Mesdhe.

Qëllimi i ligjit është të sigurojë një shfrytëzim racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike ujore dhe zhvillimin e akuakulturës; të organizojë më mirë menaxhimin e sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës; të marrë masa për ruajtjen për të siguruar mbrojtjen e burimeve biologjike ujore; të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve të peshkimit dhe akuakulturës, si edhe të krijojë kushte më të mira socio-ekonomike për prodhuesit; të sigurojë kërkesën dhe interesat

e konsumatorëve duke futur në tregje produkte peshkimi të lejuara për konsum njerëzor; dhe të nxisë dhe rregullojë kërkimet shkencore dhe teknologjike në sektorët e peshkimit dhe akuakulturës.

Ligji parashikon krijimin e Komisionit Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën (gjithashtu i quajtur Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, me degë në nivel kombëtar dhe lokal). Dega qendrore ndodhet pranë MMPAU-t dhe në nivel rajonal, Komisionet Lokale për Peshkimin dhe Akuakulturën kanë lidhje të ngushta me autoritetet e administratës vendore.

Ligji përmban dispozita për peshkimin dhe ndalimin e peshkimit, një nga të cilat është ndalimi për të ndryshuar cilësinë e ujërave dhe drejtimin e rrjedhës së tyre në mënyrë që të mos dëmtojnë mjedisin e llojeve ujore apo strukturat e akuakulturës, me përjashtim të rasteve të autorizuara në përputhje me ligjin. Pajisja me leje për zhvillimin e akuakulturës është përgjegjësi e MMPAU-t në bashkëpunim me ministritë e tjera të interesuara.

“Zonë e mbrojtur peshkimi” është një zonë gjeografikisht e përcaktuar e sistemit ujor, në të cilën të gjitha aktivitetet e peshkimit janë përkohësisht ose në mënyrë të përhershme të ndaluara ose të kufizuara, me qëllim përmirësimin e shfrytëzimit dhe ruajtjen e burimeve ujore të gjalla ose mbrojtjen e ekosistemeve ujore.

Ligji përmban një kre për menaxhimin e lagunave dhe ujërave të tjera të grykëderdhjes ku janë renditur marrëveshjet për menaxhimin (duke përfshirë zonat ku ndalohet peshkimi në një zonë të veçantë rreth deltës apo hapjes së lagunave natyrore apo artificiale). Ky vendim menaxhimi mbulon rreth 1% të ujërave territoriale.

Kontrolli i zbatimit të këtij ligji dhe rregulloreve përkatëse vijuese realizohet nga Inspektorati i Peshkimit (neni 36) i këtij ligji). Inspektorati i Peshkimit bashkëpunon me Inspektoratin e Mbrojtjes së Mjedisit, publikun dhe policinë financiare, kapiteneritë e portit, forcat ushtarake dhe organe të tjera. Inspektorët e Peshkimit, kur vërejnë shkelje të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kanë për detyrë dhe të drejtën për të ndaluar shkelësin dhe konfiskuar mjetin lundrues.

B.3. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 10 431, datë 09.06.2011)

Ligji Nr. 10431 për Mbrojtjen e Mjedisit i vitit 2011 zëvendëson Ligjin Nr. 8934 të vitit 2002 dhe bën përafrimin e Direktivës 2004/35/EC për përgjegjësinë mjedisore. Ligji hyri në fuqi në vitin 2012. Ai ofron një bazë të qartë ligjore dhe kuadrin për përafrimin e mëtejshëm të një numri të madh direktivash në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Akte të shumta të reja nënligjore kërkohen për zbatimin e Ligjit të ri. Disa drafte të këtyre akteve nënligjore janë përgatitur tashmë, p.sh. VKM-ja për Zbatimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve dhe VKM-ja për Aksesin e Publikut ndaj Informacionit Mjedisor.

Ligji krijon kuadrin për mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Ai përfshin në mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjen e përbërësve të mjedisit, mbrojtjen e mjedisit gjatë procesit të planifikimit, parandalimin dhe kontrollin e ndotjes (duke përfshirë seksione për normat e mjedisit dhe lejet mjedisore), monitorimin e gjendjes së mjedisit, informacionin mjedisor, përgjegjësinë mjedisore, organet shtetërore përgjegjëse dhe shkeljet administrative.

B.4. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 10 440 , datë 07.07.2011)

Ligji Nr. 10440, i vitit 2011 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim përmirësimin e sistemit ekzistues të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) . Ai është përafshuar plotësisht me Direktivën e datës 27.06.1985 “Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin” e ndryshuar me Direktivën 97/11/EC, Direktivën 2003/35/EC dhe Direktivën 2009/31/EC (Kreu 2).

Ky ligj rishikon dhe përditëson Ligjet e mëparshme (Nr. 8990, datë 23.01.2003 dhe Nr. 10050, datë 24.12.2008)

Ligji ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte që ende nuk janë vënë në zbatim, si edhe mundëson një proces të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis.

Ai krijon bazën për kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative. Ligji përfshin nënë e mëposhtme: procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, palët dhe konsultimi gjatë procesit të VNM-së, dhënia e informacionit dhe ruajtja e të dhënave konfidenciale, vendimi i autoritetit të planifikimit, vlerësimi i ndikimit në mjedisin ndërkufitar, ekspertët e VNM-së, ankimi dhe sanksionet.

C. Kuadri i politikave për ZMD-të

C.1. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin

Si pjesë e detyrimeve të saj që burojnë nga Konventa e Diversitetit Biologjik (KDB, e ratifikuar në vitin 1996), Shqipëria hartoi Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin (SKPVB). E miratuar në vitin 1999, SKPVB-ja përfshin disa rekomandime të posaçme, si hartimin e një programi monitorimi të biodiversitetit, një mekanizmi për mbledhjen e informacionit, si edhe krijimin e sekretariatit për biodiversitetin. Këshilli Kombëtar për Natyrën dhe Biodiversitetin (KKNB), i krijuar në vitin 2000 me anë të një Dekreti, i kryesuar nga Zëvendës Kryeministri, përfshinte të gjitha ministratë përkatëse dhe ishte përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e SKPVB-së. Në vitin 2002, pas krijimit të Ministrisë së Mjedisit, sot Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), të gjitha funksionet e KKNB-së i kaluan kësaj Ministrie.

Objektivat kryesorë të zbatimit të SKPVB-së në Shqipëri janë si më poshtë:

- Ruajtja dhe përmirësimi i diversitetit biologjik dhe peizazhor të vendit
- Përfshirja e parimeve dhe politikave të përdorimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të biodiversitetit, dhe
- Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Strategjia përcakton drejtimet kryesorë të ruajtjes së biodiversitetit dhe habitateve, nëpërmjet identifikimit dhe shpalljes së tyre si zona të mbrojtura, si edhe përmes mbrojtjes së llojeve brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura.

Që nga hartimi i saj, janë zbatuar një sërë rekomandimesh të strategjisë si:

- Hartimi dhe zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2006, dhe Ligjit për Zonat e Mbrojtura, 2002, i ndryshuar;
- Përcaktimi i Zonave të Mbrojtura të reja: rritja e mbulimit të zonave të mbrojtura nga 5 % në 12.57 %, sipas projektit të rrjetit të propozuar në strategji, duke pasur parasysh elementet e rrjetit ekologjik evropian dhe udhëzimet ndërkombëtare duke përfshirë edhe ato evropiane;
- Përgatitjen dhe zbatimin e planeve të veprimit për llojet e veçanta të rrezikuara dhe llojet endemike të faunës së egër dhe florës (ndërmjet të tjerave 2 plane veprimi janë hartuar për cetacetë dhe lëndinat e *Posidonia oceanica*);
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ligatinat, 2006 është një tjetër dokument që plotëson kuadrin e planeve për elementet e biodiversitetit;
- Një dokument tjetër kombëtar është plani i veprimit për mjedisin global që ka të bëjë me zbatimin e tri konventave të Kombeve të Bashkuara, të ashtuquajturat Konventat e Rios (Biodiversiteti, Ndryshimet Klimatike dhe Shkretëtirëzimi).
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 84, datë 27.1.2009 “Për përcaktimin e kriterëve për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit” plotëson një element të nevojshëm për të pasur një rrjet funksional të monitorimit të biodiversitetit.

Sipas Raportit të Katërt Kombëtar për Konventën e Kombeve të Bashkuara për Diversitetin Biologjik (dhjetor 2010), planet e ardhme për biodiversitetin konsistojnë në:

- Rritjen e mëtejshme të mbulimit të sipërfaqeve të Zonave të Mbrojtura deri në 17 % në vitin 2013;
- Zbatimin e planeve ekzistuese të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura dhe hartimin e planeve të reja për Zonat e Mbrojtura të mbetura;
- Zbatimin e planeve ekzistuese të veprimit për llojet dhe hartimin e planeve të reja për llojet e kërcënuara dhe endemike në shkallë globale për të siguruar statusin e favorshëm të ruajtjes së tyre;

- Ngritjen e një rrjeti të monitorimit dhe inventarizimit të biodiversitetit në përputhje me dispozitat e reja ligjore që kanë hyrë në fuqi;
- Zbatimin e rrjetit Smerald të Zonave me Interes të Veçantë Ruajtjeje (ASCIs) si kontribut për Rrjetin Ekologjik Pan-Evropian (PEEN) dhe Strategjinë Pan-Evropiane për Diversitetin biologjik dhe Peizazhor (PEBLDS).
- Rishikimin e Programit Kombëtar të Punës për Zonat e Mbrojtura në perspektivën e zhvillimeve të reja nga KDB-ja dhe CoP;
- Vlerësimin e arritjeve të objektivit për ndalimin e humbjes së biodiversitetit deri në vitin 2010, në përputhje me qasjen e Agjencisë Evropiane të Mjedisit (AEM).

C.2. Strategjia e Turizmit dhe Strategjia për Trashëgiminë Kulturore

Të dyja këto instrumente politikash kanë për qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore dhe në veçanti zhvillimin e zonave të mbrojtura natyrore, vendeve me vlera kulturore dhe historike dhe peizazhet natyrore.

Në një dokument të titulluar “Strategjia Sektoriale e Turizmit 2007 – 2013”⁹ (E miratuar me VKM-në Nr. 884, datë 11.06.2008 “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Turizmit”), Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, rishikoi Strategjinë për Zhvillimin e Turizmit (2003) dhe ndërveprimin e saj me Strategjinë për Zhvillimin e Turizmit Natyror dhe Mjedisor (qershor 2006) si edhe Planin përkatës të Veprimit.

Në këtë dokument u njoh nevoja “për të krijuar një cikël të drejtë të zhvillimit të qëndrueshëm të bazuar tek turizmi Qeveria e Shqipërisë, duhet të mbrojë dhe të rivlerësojë së bashku me autoritetet vendore, operatorët turistikë dhe OJF-të, vendet, parqet, qytetet dhe zonat e mbrojtura, që janë asetet qendrore të sektorit të saj të turizmit”.

U theksua që “Ekoturizmi duhet parë si prioritet duke pasur parasysh potencialin dhe rolin e rëndësishëm që ai luan në funksion të zhvillimit të Turizmit Kulturor (...) Nevojitet bashkërendim optimal i punës me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si Institucioni përgjegjës për zhvillimin e zonave mjedisore të mbrojtura, burimeve natyrore dhe ndikimin e turizmit në mjedis”.

Duke pasur parasysh që “tashmë, turistët vlerësojnë një përgjegjësi mjedisore të vendit dhe përpjekjet për ruajtje dhe që “konsumatorët nga vendet e zhvilluara duhet të ndryshojnë vendimet e tyre për blerje, duke u bazuar në perceptimin e ndikimeve apo të performancës mjedisore negative”, Shqipëria duhet se kishte “një vendndodhje ideale për të përmbushur kërkesat e ndryshueshme për një treg turistik të orientuar gjithnjë e më shumë drejt natyrës dhe kulturës”.

Kësisoj, “bashkërendimi ndërmjet një numri të madh institucionesh qeveritare” dhe “përpjekjet e bashkërenduara të një numri ministrish, njësite të qeverisjes vendore, instituteve, si edhe OJF-ve, Akademisë së Shkencave, agjencive

ndërkombëtare dhe programeve dypalëshe të asistencës” u konsideruan si disa nga sfidat kryesore për sigurimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe ekologjik.

Dhjetë vjet më parë u hartua strategjia për Turizmin. Sot, ekziston nevoja për analizë të mëtejshme (boshllëqet, informacioni i disponueshëm) në veçanti për sa i përket ndikimit të ZMD-të.

Shqipëria ka bërë një progres të konsiderueshëm në mbrojtjen e biodiversitetit nëpërmjet kuadrit legjislativ dhe institucional, si edhe duke marrë disa hapa konkrete në këtë drejtim. Progresi më i rëndësishëm i arritur është ai i mbulimit të Zonave të Mbrojtura në vend i cili u dyfishua gjatë një periudhe pesë-vjeçare. Zonat e mbrojtura në vitin 2010 përbënin rreth 13 % të territorit të vendit dhe sot kjo shifër ka shkuar në 15 %. Zhvillimi i ZMD-ve është marrë parasysh edhe në SKPVB dhe kohët e fundit edhe nga Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe bregdetare (INCA/IRNSH, MMPAU, zyra e PNUD-it në Shqipëri, 2013).

II. RREGULLIMET INSTITUCIONALE PËR ZONAT E MBROJTURA DETARE

A. Organet qeverisëse të ZM-ve

Ky seksion paraqet kuadrin ekzistues institucional për ZM-të/ZMD-të në Shqipëri, duke përfshirë organet qeverisëse në nivel kombëtar dhe lokal.

A.1. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU)¹⁰

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) është organizata kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës. Misioni i Ministrisë është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës si edhe për të mundësuar aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Përmbushja e këtij misioni realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes, nismëtimit dhe bashkërendimit të veprimtarive që çojnë në një zhvillim dhe mirëqenie afatgjatë, përmes mbrojtjes së natyrës dhe rritjes së ndërgjegjësimit të opinionit publik.

Detyrat kryesore të MMPAU-t përfshijnë:

- Zbatimin e politikave përkatëse kombëtare,
- Përcaktimin e investimeve me prioritet në mjedis dhe pyje,
- Hartimin e programeve kombëtare të kërkimit në fushën e mjedisit, dhe
- Bashkërendimin e veprimtarive në fushën e mbrojtjes së mjedisit të ministrive të tjera dhe autoriteteve vendore.

¹⁰ Për një analizë të hollësishme të kuadrit institucional për mjedisin në Shqipëri, autorët rekomandojnë leximin e “Shqipëria - Rishikimet e Performancës Mjedisore. Rishikimi i Dytë” i publikuar nga Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara (UNECE) në vitin 2012. http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/epr/epr_studies/Albania11.pdf

⁹ http://www.dsdc.gov.al/dsdc/pub/strategy_of_tourism_2007_2013_1033_1.pdf

MMPAU mund të propozojë masa për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, pyjeve dhe burimeve ujore dhe është përgjegjëse për zbatimin e politikës së ujit dhe politikës së pyjeve.

Në strukturën organizative të MMPAU-t përfshihet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore, e cila nga ana e saj përbëhet nga Drejtoria e Biodiversitetit pjesë e së cilës është edhe Sektori i Zonave të Mbrojtura dhe Parqeve Kombëtare. Bashkëpunimi shtrihet në Drejtori të tjera brenda Ministrisë si edhe në institucionet e zbatimit, si Agjencitë në rrethe të cilat në përbërjen e tyre kanë përfshirë edhe administrimin e zonave të mbrojtura.

MMPAU gjithashtu merret me hartimin e projekt-politikave për mbrojtjen e natyrës veçanërisht për ruajtjen e biodiversitetit, si edhe me legjislacionin. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në fushën e mbrojtjes së natyrës bashkëpunon me: Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për biodiversitetin në bujqësi; me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, duke siguruar vendimmarrjen në lidhje me përdorimin e territorit; me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila harton dhe zbaton politikat për zhvillimin e turizmit; dhe me Ministrinë e Brendshme, për menaxhimin e burimeve natyrore lokale.

Rrjeti Kombëtar i Monitorimit

Rrjeti Kombëtar i Monitorimit është ngritur për të realizuar monitorimin e cilësisë dhe ndryshimeve në gjendjen e mjedisit dhe në institucionet e specializuara që mbulojnë monitorimin e të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit (Ligji për Mjedisin, 2011).

A.2. Organe të tjera qeverisëse përkatëse

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)¹¹

Në vitin 2009, Qeveria e Shqipërisë ngriti Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, për t'iu përgjigjur rekomandimit të Organizatës Ndërkombëtare Detare (brenda kuadrit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Detare- UNCLOS). Ky institucion ndërmintor duhet të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planifikimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ministritë e përfshira në këtë institucion janë Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Misioni i QNOD-së është të garantojë menaxhimin dhe kontrollin e kufijve detarë të Shqipërisë, sigurinë e jetës në det dhe ndërveprimin e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi dhe interesa brenda hapësirës detare.

QNOD-ja është një institucion kombëtar që garanton sovranitetin dhe të drejtat e patjetërsueshme të shtetit shqiptar në hapësirën detare nëpërmjet menaxhimit të integruar të burimeve kombëtare të institucioneve që kanë përgjegjësi dhe interesa për hapësirën detare.

QNOD-ja bashkërendon dhe drejton:

— Operacionet bregdetare për kontrollin e kufirit detar;

— Operacionet bregdetare kundër trafikut të paligjshëm;

— Operacionet bregdetare në luftën kundër terrorizmit;

— Operacionet bregdetare kundër krimit të organizuar;

— Operacionet e Kërkim-Shpëtimit, si edhe ndihmën e parë në det;

— Operacionet Kundër Ndotjes;

— Operacionet për mbrojtjen e peshkimit;

— Operacionet për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe mjedisit detar;

— Operacionet për mbrojtjen dhe miradministrimin e pasurive peshkore (bio-matja etiologjike);

— Operacionet e sigurisë në det.

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është pjesë e qeverisë shqiptare përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për turizmin, kulturën, rininë dhe sportet.

Një përqindje e rëndësishme e të ardhurave kombëtare të Shqipërisë vjen nga turizmi. Turizmi- për sa i përket vitit 2013 – financon 10% të produktit të brendshëm bruto, dhe pritet që kjo shifër të rritet në mënyrë të ndjeshme në dekadën e ardhshme. Në vitin 2011 Shqipëria renditej si destinacioni më i mirë i udhëtimeve në mbarë botën. Pjesa më e madhe e industrisë së turizmit është përqendruar përgjatë brigjeve të deteve Adriatik dhe Jon. Deti Jon ka plazhet më të bukura dhe të virgjra, dhe shpesh quhet Riviera Shqiptare. Numri i vizitorëve është rritur ndjeshëm, Shqipëria kishte vetëm 500.000 vizitorë në vitin 2005 ndërsa në vitin 2012 ajo u vizitua nga rreth 4.2 milion turistë. Një rritje prej 840% në vetëm 7 vjet¹².

Mandati, roli dhe funksionet e Ministrisë së Turizmit në lidhje me mjedisin detar në përgjithësi dhe ZMD-të në veçanti nuk janë të qarta por ajo mund të luajë një rol në të ardhmen, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e veprimtarive brenda dhe rreth zonave të mbrojtura, si edhe në mbledhjen e tarifave të hyrjes apo licencimin e disa veprimtarive që do të ndihmonin në menaxhimin e ZMD-ve apo ZM-ve.

11 http://www.mod.gov.al/eng/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=221&Itemid=574

12 <http://en.wikipedia.org/wiki/Albania>

III. QEVERISJA DHE MENAXHIMI I POSAÇËM I ZONAVE TË MBROJTURA DETARE

A. Qeverisja

A.1. Procedurat e shpalljes dhe krijimit të ZM-ve (duke përfshirë edhe ZMD-të)

Neni 13 i Ligjit për Zonat e Mbrojtura përkrah procesin e shpalljes së një zone të mbrojtur ndërsa Neni 14 jep detajet e përmbajtjes së shpalljes.

“1. Shpallja e një zone të mbrojtur dhe zonimi i saj bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin, pas marrjes së mendimit të institucioneve të specializuara dhe të organeve të qeverisjes vendore, të cilat kanë marrë, paraprakisht, mendimin e pronarëve privatë, në rast se pronat e tyre përfshihen në zonën e mbrojtur.

2. Këshilli i Ministrave miraton procedurat për propozimin dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike. Ato përgatiten nga Ministria e Mjedisit në mbështetje të kriterëve të konventës së biodiversitetit, të udhëzimeve përkatëse të Bashkimit Evropian dhe të planeve e strategjive mjedisore kombëtare.

3. Çdo person fizik a juridik ka të drejtë t'i kërkojë ministrisë që territori i vet privat ose pjesë e objekteve natyrore të veta, të shpallen ose të përfshihen në njërin nga kategoritë e zonave të mbrojtura”.




Figura 1:
Procesi i përcaktimit të një ZMD-je të re në Shqipëri.

B. Menaxhimi

B.1. Përkufizimi dhe kategoritë e ZM-ve (duke përfshirë edhe ZMD-të)

Siç u përmend më sipër, legjislacioni shqiptar nuk përmban një përkufizim të veçantë për ZMD-të, duke u përfshirë kështu në përkufizimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura.

Neni 3(1) i Ligjit për Zonat e Mbrojtura (Nr. 8906, viti 2002)¹³:

“Zona të mbrojtura” shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore”.

Sipas nenit 2 të Ligjit për Zonat e Mbrojtura (Nr. 8906, viti 2002), “Kategorizimi i zonave, statusi dhe niveli i mbrojtjes për secilën zonë mbështetet në kriteret e IUCN-së”.

Sipas nenit 4, ka gjashtë (6) kategori ZM-sh:

- rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor/ (Kategoria I);
- park kombëtar (Kategoria II);
- monument natyror (Kategoria III);
- rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV);
- peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).

Ndonëse Ligji shqiptar për Zonat e Mbrojtura (LZM) i përfshin kategoritë e IUCN-së, ato janë formuluar me një fokus të madh mbi tokën dhe prandaj lloje të ndryshme veprimtarish të ndaluara apo të lejuara në varësi të kategorisë dhe si rrjedhim edhe të nivelit të mbrojtjes, nuk kanë lidhje me ZMD-të dhe mund ta ndërlikojnë zbatimin e ligjit për zonat e mbrojtura detare¹⁴.

Një zonë buferike mund të shpallet rreth një zone të mbrojtur dhe ndryshimi i vitit 2008 i LZM-së prezanton parimin e zonimit të brendshëm. Neni 4/2 parashikon që çështja e zonimit të territorit të zonës së mbrojtur shtjellohet duke përmendur që VKM-ja që shpall zonën e mbrojtur, përcakton emërtimin, sipërfaqen dhe shkallën e mbrojtjes së nënzonave që bëjnë pjesë në të. Territori i zonës së mbrojtur ndahet në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe ekosistemeve, ndërsa zonimi i brendshëm mund të përmbajë zonën qendrore, zonën e rekreacionit, zonën e përdorimit tradicional, zonën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe nënzona të tjera që i përshtaten territorit. Një zonim i ngjashëm mund të përdoret si një instrument i rëndësishëm menaxhimi për krijimin e ZMD-ve që mund të sjellë përfitime të shumëfishta, si ndërthurja e menaxhimit të peshkimit me ruajtjen e natyrës apo turizmin e qëndrueshëm.

¹³ Përkthimin në anglisht mund ta gjeni në <http://faolex.fao.org/docs/pdf/alb60472E.pdf>

¹⁴ Raporti i Shqipërisë për Zonat e Mbrojtura Detare, Raporti Përfundimtar, tetor 2009, Milieu.

B.2. Plani i Menaxhimit

Planet e Menaxhimit për zonat e mbrojtura përshkruhen në Ligjin për Zonat e Mbrojtura, Neni 15:

1. Ministria e Mjedisit, organet e tjera shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore ose në bashkëpunim me të tretët, hartojnë për secilën zonë të mbrojtur planet e menaxhimit të kësaj zone.
2. Të gjitha planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur, që nuk janë hartuar nga Ministria e Mjedisit, duhet të miratohen nga kjo Ministri, për të siguruar përputhshmërinë me objektivat e këtij ligji ose të ligjeve të tjera që lidhen me të.
3. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur do të përfshihen në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë qeveritare, që lidhen me to, dhe në vendimmarrjen në nivele kombëtare, rajonale ose vendore.
4. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur do të përfshijnë të paktën:
 - a) objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur;
 - b) mekanizmat dhe autoritetin drejtues, si të Ministrisë së Mjedisit, ashtu edhe të organeve të tjera shtetërore ose të organizatave të tjera ose personave juridikë e fizikë;
 - c) proceset dhe kategoritë e veprimtarive, të cilat kërcënojnë ose janë kërcënuese për zonën e mbrojtur, duke përfshirë edhe zonat rrethuese;
 - c) masat rregullatore ose administrative që nevojiten për të shmangur ose pakësuar kërcënimet e identifikuara;
 - d) veprimtaritë e lejuara brenda zonës së mbrojtur;
 - d) veprimtaritë e dhura për zonat përreth, duke përfshirë ato në zonat buferike dhe më tej;
 - e) kushtet për kontrollin e turizmit dhe të shërbimeve të tjera;
 - ë) të dhënat për pronësinë e mëparshme të truallit dhe të drejtat për të përdorur elementet e diversitetit biologjik brenda tij, duke përfshirë veprimtaritë tradicionale për jetesën e popullatës ose të bashkësisë vendore;
 - f) kushtet për të zhvilluar veprimtari tradicionale për jetesë, të zonës ose të elementeve të diversitetit biologjik brenda saj, nëse ato nuk bien ndesh me objektivat e administrimit të zonës së mbrojtur;
 - g) kushtet për të ndarë përfitimet nga krijimi dhe administrimi i zonës së mbrojtur, veçanërisht, me bashkësitë dhe popullatat vendore;
 - gj) kushtet për kërkim shkencor, inventarizim dhe monitorim;
 - h) burimet financiare, duke përfshirë ato që sjellin fitim;
 - i) kushte të tjera të veçanta për zonën në fjalë.
5. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur do të rishikohen dhe do të ripunohen periodikisht, në përputhje me nevojat e kohës.

Sipas Nenit 17, zbatimi i planit të menaxhimit është përgjegjësi e "administratës së zonës së mbrojtur" ndërsa ndjekja e zbatimit të planit të menaxhimit bëhet nga një komitet menaxhimi "përbërja, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Është me interes të theksojmë që koncepti i delegimit është prezantuar në të njëjtin nen: "Për zbatimin e planeve të menaxhimit mund të angazhohen institucione publike dhe private, persona juridikë, vendas ose të huaj, organizata jofitimprurëse mjedisore, duke zbatuar rregullat dhe procedurat e konkurrencës dhe tenderimit."

C. Financimi

Aktualisht, Ligji nuk parashikon rregulla në lidhje me financimin e zbatimit apo menaxhimit dhe masave të ruajtjes për ZMD-të. Dhe në të njëjtën mënyrë si pjesë të rëndësishme të investimeve në mjedis në Shqipëri janë mbështetur fuqishëm nga asistenca e donatorëve që nga EPR-ja e parë, edhe ZM-të janë financuar nëpërmjet projekteve ndërkombëtare. Për fat të keq, rezultatet mbeten të kufizuara. Në këtë drejtim, u hartua një dokument për krijimin e një Fondi Mjedisor por deri më sot ende nuk ka filluar të funksionojë.

Tabela e mëposhtme është marrë nga Programi i Bashkëpunimit 2012-2016 ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara¹⁵:

Rezultati 2.2: Autoritetet dhe institucionet kombëtare, sektori privat dhe publiku i gjerë i mbrojnë, ruajnë dhe përdorin burimet natyrore në mënyrë më të qëndrueshme, duke pasur parasysh ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe përmbushjen e standardeve mjedisore evropiane.

Rezultatet 2.2.1 Qeveria Kombëtare ka gati mekanizma ligjorë dhe rregullatorë për zbatimin dhe siguron përmbushjen e Marrëveshjeve Shumëpalëshe për Mjedisin dhe Parimet e Konventave të Rios.

Treguesi 1: Zonat e përzgjedhura të kuadrit ligjor kombëtar janë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe instrumentet ekonomike për mjedisin janë të disponueshme.

Baza: Numër i kufizuar instrumentesh ekonomike, vetë-qëndrueshmëri financiare dhe aftësi teknike të kufizuara.

Synimi: Krijimi i Fondit Mjedisor, amendimi i ligjeve për akcizat dhe taksat mjedisore dhe plotësimi i detyrimeve përkatëse të Traktatit Euratom.

15 <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/GoA-UN-Cooperation-Programme.pdf>

Pjesa II

Analiza e grupeve të interesit për zonat e mbrojtura detare në Shqipëri

I. GRUPE TË TJERA TË RËNDËSISHME TË INTERESUARA PËR RUAJTJEN E MJEDISIT DETAR

Përveç organeve qeveritare dhe autoriteteve të menaxhimit që u përshkruan në PJESËN I, ka edhe lloje të tjera grupesh të interesuara që duhen marrë parasysh në rastin e ZMD-ve. Ato mund të grupohen si më poshtë:

- Shoqëria civile (jo-fitimprurëse): ky grup përfshin universitetet, institutet e kërkimit, OJQ/OJF-të, organizatat e komunitetit vendas, etj.
- Sektori privat (fitimprurëse): ky grup përfshin firmat, organizatat profesionale të peshkimit, operatorët turistikë, zhvilluesit/ndërtuesit bregdetarë, etj.
- Grupe të tjera interesi dhe publiku i gjerë.

Ky studim, duke ndjekur një qasje institucionale nuk e përfshin përshkrimin e sektorit privat në analizën e grupeve të interesit.

A. Institutet akademike dhe kërkimore në fushën e mjedisit detar

Të gjitha institutet e mëposhtme tashmë e luajnë apo mund të luajnë një rol në studimin, hulumtimin dhe monitorimin e mjedisit detar. Mund të jetë e rëndësishme të sqarohet përgjegjësia e secilit prej tyre për të mënjanuar dublikimin e përpjekjeve.

Akademia e Shkencave

Akademia e Shkencave u krijua në vitin 1972. Funkzioni i saj sot mbështetet në Ligjin Nr. 9182, datë 02. 05. 2004 "Për Akademinë e Shkencave në Shqipëri". Ajo ka qenë një ndër institucionet shkencore më të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë, por pas reformës së viteve 2006-2007 ku pjesa më e madhe e institucioneve të saj shkencore iu bashkuan Universiteteve, ajo është shndërruar në një institucion nderi.

Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit

Instituti i Hidrometeorologjisë u bë pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës duke u shndërruar në Institutin e Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ushtron veprimtarinë e tij në fushën e gjeoshkencave në mbështetje të Ligjit Nr. 8366, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më datë 02.07.1988, sipas së cilit ai është një organ këshillimi shkencor dhe teknik në lidhje me gjendjen në fushën e gjeoshkencave. Instituti është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe detare, vlerësimin e rrezikut dhe ndotjen e dheut.

B. OJQ/F-të

Organizatat JO-Qeveritare/Fitimprurëse (OJQ/F-të) janë aktorë kyç në hartimin dhe zbatimin e politikës mjedisore dhe kanë mundësinë të plotësojnë agjencitë qeveritare me nivelet e duhura të transparencës dhe pjesëmarrjes, nga niveli kombëtar në atë lokal. Kështu, OJQ/F-të mund të sigurojnë transparencën dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile duke kontribuar në struktura dhe mekanizma të mira qeverisjeje. OJQ/F-të kryesore me rol potencial në legjislacionin, identifikimin, përzgjedhjen, menaxhimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me zonat e mbrojtura detare janë renditur më poshtë, por edhe të tjera mund të merren parasysh në nivel lokal. Në faqen e internetit të Qendrës Rajonale Mjedisore (Shqipëri) mund të gjenden OJQ/F të tjera të regjistruara¹⁶.

B.1. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (IRNSH)

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri- INCA është një OJQ/F e krijuar në korrik të vitit 2000. Qëllimi kryesor i INCA-s është të lehtësojë dhe ndihmojë ngritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimit dhe qasjes pjesëmarrëse, mbrojtja e mjedisit, ruajtja e thesareve natyrore të mjedisit dhe zhvillimit rural në vend, mbrojtja e florës dhe faunës, vlerësimi i biodiversitetit, menaxhimi i zonave të mbrojtura, rritja e ndërgjegjësimit të publikut, politikës dhe vendimmarrësve, si edhe marrja e masave të ruajtjes sipas rastit për të mbrojtur llojet dhe habitatet e tyre kritike. Detyrë e Institutit është gjithashtu të lidhë çështjet e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit me të

¹⁶ <http://www.albania.rec.org/>

gjitha temat dhe fushat e tjera të shkencës që kanë ndikim në burimet natyrore në Shqipëri. Instituti do të jetë gjithashtu pjesë e procesit të përmirësimit të legjislacionit në vend dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve në Shqipëri, institucionet mjedisore dhe integrimin evropian. Për sa i përket zonave të mbrojtura, INCA ka kontribuar në disa projekte si Vlerësimi i Boshllëqeve i Zonave të Mbrojtura dhe Zhvillimi i Zonave të Mbrojtura Detare (maj 2008 – qershor 2010) dhe aktualisht është përfshirë në projektin për mbështetjen institucionale ndaj Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për Ruajtjen e Qëndrueshme të Biodiversitetit dhe Përdorimin e Zonave të Mbrojtura që financohet nga Bashkëpunimi Italian dhe që zbatohet nga IUCN-ja (shtator 2011 – dhjetor 2013).

B.2. Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri (MRMNSH)¹⁷.

PPNEA nëpërmjet veprimeve të saj është përfshirë në çështje të ndryshme si pyjet, peizazhi, kafshët e egra, zhvillimi rural, etj. PPNEA është përfshirë së bashku me aktorë të tjerë në menaxhimin e përbashkët të Basenit ujqor të Liqeneve të Prespës (Komiteti i Menaxhimit). PPNEA për momentin po punon për "Mbështetjen institucionale ndaj Ministrisë Shqiptare të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për Ruajtjen e Qëndrueshme të Biodiversitetit dhe Përdorimin e Zonave të Mbrojtura, që financohet nga Bashkëpunimi Italian dhe që zbatohet nga IUCN-ja (shtator 2011 – dhjetor 2013). Në të njëjtin kontekst, PPNEA kohët e fundit nismëtoi një projekt që ka për synim mbrojtjen dhe zhvillimin e përbashkët të zonës së mbrojtur të Sharr-Korabit me pjesëmarrjen e aktorëve lokalë.

B.3. Shoqata e Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë (SHMGJUSH)

Prioritetet e punës janë: mbrojtja e kafshëve, biodiversiteti, edukimi mjedisor, mbrojtja e natyrës, publikimet dhe menaxhimi i ujërave. Veprimtaritë kryesore të shoqatës janë: fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit, konferencat, takimet, edukimi, shpërndarja e informacionit, monitorimi, takimet me publikun, kërkimi dhe trajnimi.

C. Publiku

Në Shqipëri, informimi i publikut për çështjet mjedisore është një e drejtë kushtetuese siç përcaktohet në nenin Nr. 56, të Ligjit të vitit 2002 për Mbrojtjen e Mjedisit ku thuhet se "*Kushdo ka të drejtë të informohet në lidhje me gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij*". Ligji i vitit 2011 për Mbrojtjen e Mjedisit e rikonfirmon këtë të drejtë në nenin Nr. 46 në të drejtën për të marrë dhe/ose përdorur informacionin mjedisor. Gjithashtu, Shqipëria është një nga pionieret e Konventës së Aarhusit, pasi ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm gjatë gjithë procesit të saj të përgatitjes dhe ishte një nga vendet e para që e ratifikoi atë në vitin 2001.

¹⁷ <http://www.ppnea.org/about.html>

Gjithashtu, në vitin 2005, Kryeministri nxori Urdhrin Nr. 202 për Përmirësimin e Transparencës nëpërmjet Rritjes së Përdorimit të Internetit dhe Përmirësimit të Faqeve Ekzistuese të Internetit, me qëllim përmirësimin e punës së kryer nga institucionet publike përmes rritjes së përdorimit të Internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të Internetit. Si pasojë, MMPAU, si edhe ministrinë e tjera kanë detyrimin për të vënë në dispozicion të publikut në faqet e tyre të internetit të gjithë informacionin mjedisor që zotërojnë.

II. PROJEKTET NË VAZHDIM DHE KRIJIMI I RRJETEVE

A. Projektet ndërkombëtare

Në kuadrin e veprimtarive të projektit MedMPANet (RAC/SPA) dhe projektit MedPAN South (WWF-MedPo), u organizuan sesione trajnimi të ndjekura nga veprime për rritjen e kapaciteteve të vendeve përfituese për të arritur synimet e peshkimit të qëndrueshëm brenda ZMD-ve. Një raport i titulluar "Mbrojtja e Biodiversitetit Detar në Shqipëri" Parku Kombëtar Detar Karaburun – Sazan", u hartua në vitin 2011 nga OJQ-ja kombëtare, INCA, si një kontribut i parë për të filluar ngritjen e një bazë të dhënash për peshkimin dhe zbatuar disa veprimtari në promovimin e ZMD-së së krijuar rishtazi.

Një tjetër projekt kyç që ka të bëjë me ZMD-të dhe ZMDB-të në Shqipëri është ai i quajtur "Përmirësimi i Mbulimit dhe Efektivitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare", i bashkëfinancuar nga Faciliteti Global Mjedisor dhe i menaxhuar nga PNUD-i në bashkëpunim me MMPAU-n¹⁸. Projekti do të zbatohet gjatë periudhës 2011-2016. Rezultatet kryesore të projektit do të jenë:

- Hartimi i Planit Strategjik të ZMDB-ve duke përfshirë edhe skenarin e zgjerimit të ZMDB-ve me një vizion 10 vjeçar (shikoni Kutinë 1);
- Ngritja e një sistemi të thjeshtë monitorimi për zbatimin e ZMDB-ve në nivel lokal; mbështetje e veçantë për administratën e ZMD-së së Karaburun-Sazanit dhe për institucione të tjera përkatëse lokale për zbatimin pa probleme të sistemit të monitorimit, duke zgjidhur konfliktet, kontradiktat dhe/ose mbivendosjen ndërmjet institucioneve kombëtare dhe lokale;
- Udhëzuesi për zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të zgjerimit të ZMD-së, duke mbuluar çështje si: kufizimet e ndërtimeve përgjatë bregdetit, prezantimi/ modifikimi i treguesve të ngarkesave të turizmit, ndalimi me ligj i zjarreve, rregullimi me ligj i kullotave të bagëtisë në lagunat dhe ligatinat bregdetare etj.
- Përgatitja e një dokumenti udhëzues për krijimin e mekanizmit financues për ZMDB-të;
- Projekti më tej do të mbështesë ZMD-në e Karaburun-Sazanit duke përfshirë hartimin e planeve të menaxhimit dhe biznesit;

¹⁸ http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/projects/environment_and_energy/protecting-albania-s-marine-and-coastal-biodiversity/

- Krijimi i zonave buferike për ZM-të ekzistuese dhe për ZMD-të e reja;
- Krijimi dhe mbështetja e forumit ndërsektorial për menaxhimin e ZM-ve me funksion këshillues në nivel Ministrie;
- Një vlerësim i efektivitetit të menaxhimit të ZMDB-ve në nivel sistemi për të gjitha Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (METT).

Projekti, ndër të tjera, së fundmi hartoi “Planin Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare” që do të frymëzojë një vendimmarrje të bashkërenduar për një menaxhim hapësinor të ekosistemit duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm tekta ruan dhe menaxhon biodiversitetin dhe burimet natyrore”.

B. Krijimi i rrjeteve

■ Rrjeti i MedPAN¹⁹ i Menaxherëve të ZMD-ve në Mesdhe.

Shoqata e Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë dhe Drejtoria e Pyjeve, rrethi Vlorë- ZMD-ja e Karaburunit janë partnerë të rrjetit MedPAN.

Vizioni i MedPAN për udhërrëfyesin për vitin 2020:

“Të arrijë deri në vitin 2020 një rrjet të lidhur të Zonave të Mbrojtura Detare, përfaqësues nga pikëpamja ekologjike, të menaxhuar dhe monitoruar me efektivitet, i cili siguron ruajtjen afatgjatë të komponentëve kyç të biodiversitetit detar dhe t’i japë mbështetje solide zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit”.

Udhërrëfyesi i 2020 përbëhet nga katër objektiva strategjike:

- Krijimi i një rrjeti ekologjik të ZMD-ve që të jetë i lidhur dhe përfaqësues;
- Arritja e një menaxhimi efektiv, efikas dhe të qëndrueshëm dhe e një qeverisjeje të mirë në ZMD-të e Mesdheut;
- Zhvillimi i një qeverisjeje të integruar nga pikëpamja territoriale dhe sektoriale të ZMD-ve të Mesdheut, tekta promovon dhe ndan përfitimet mjedisore dhe socio-ekonomike;
- Rritja e alokimit të burimeve financiare për ngritjen dhe mirëmbajtjen e një rrjeti ekologjik të ZMD-ve të menaxhuara me efektivitet;

Ky udhërrëfyes përligjet nga sfidat me të cilat ende përballet rajoni në lidhje me ZMD-të. Në të vërtetë, tekta vendet janë angazhuar tashmë, ka ende nevojë për:

- Një angazhim më të madh politik,
- Nevojiten përpjekje të mëtejshme në nivel kombëtar si edhe bashkëpunim, bashkërendim dhe asistencë më e madhe reciproke në nivelin mesdhetar.
- Në të gjitha nivelet duhen zhvilluar qasje të menaxhimit të ri të integruar dhe të qeverisjes dhe duhen përkthyer në angazhime politike.

19 <http://www.medpan.org>

Kutia 1:

Zonat e Mbrojtura detare dhe Bregdetare

Burimi: Plani Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare (PSZMDB) – Projekti dhe Hartimi i Planit. Versioni i projektit përfundimtar, prill 2013. Përgatitur nga INCA/IRNSH për MMPAU-n dhe Zyrën e PNUD-it në Shqipëri, Shtojca 5.

Gjiri i Porto Palermos

Gjiri i Porto Palermos, i njohur si gjiri i Panormas në lashtësi, gjendet në juglindje të qytetit të Himarës, ndërmjet gadishullit të Panormës dhe gadishullit të Kavadonit, në Detin e Jonit. Brenda gjirit gjendet një gadishull shkëmbor tërheqës, që hyn rreth 300 metra në det.

Zona nga gryka e lumit Vjosës deri në Sazan dhe Karaburun (i gjithë Gjiri i Vlorës)

Zona përfshin Gjirin e Vlorës nga pjesa perëndimore e grykës së lumit Vjosë. Bregu lindor i gadishullit të Karaburunit nis nga Pasha Limani deri nën Kepin e Karlovecit, kalon kepet e Kallogjerit, Raguzës, Sevasinit, Shën Vasilit, Gjatës, Dim Kushtës dhe Shëngjinit, dhe përfshin lagunën e Orikumit.

Zona nga Kepi i Rodonit deri në lagunën e Patokut

Kepi i Rodonit është një kodër që ndan Erzenin nga lumi Ishëm; maja e lartë e kodrës është 223 m në Likmetaj. Vija bregdetare, e përfaqësuar nga brigjet Tortoniane me gurë ranorë dhe argjillë, është zonë e gërryer dhe në përgjithësi e jo pjellore. Vegjetacioni tokësor dominohet nga makia mesdhetare. Zona përfshin disa habitate të rëndësishme për HD dhe disa specie me interes për t'u ruajtur (Shihni Shtojcat për detaje).

Zona bregdetare nga gryka e lumit Bunë deri në lagunën e Vilunit

Gjendet në pjesën veriore të vendit dhe përfshin pjesën detare dhe bregdetare të peizazhit të zonës së mbrojtur të lumit Bunë.

Një shënim në lidhje me Rrjetin e Zonave të Mbrojtura të Adriatikut (AdriaPAN)²⁰, “një nismë nga poshtë-lart”, e cila “ka për qëllim të vendosë kontakte më lehtë ndërmjet Zonave të Mbrojtura në Detin Adriatik, të përmirësojë efektivitetin e partneritetit të tyre, si në veprimtarinë e menaxhimit edhe atë të planifikimit. AdriaPAN është një rrjet në zgjerim me një potencial të madh për bashkimin e përpjekjeve në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm”. AdriaPAN është një pjesë integrale e rrjetit më të gjerë MedPAN.

20 <http://www.adriapan.org/index.php/en/home-en>



© RAC/SPA, Mathieu Foulquié.

■ Shqipëria është po ashtu anëtare e AII, Nismës Adriatik-Jon²¹

All fillimisht u themelua me qëllimin për të siguruar zgjidhje të përbashkëta dhe të harmonizuara për problemet e përbashkëta, nga lufta kundër kriminalitetit të organizuar deri tek nevoja për të mbrojtur mjedisin natyror të Deteve Adriatik dhe Jon.

Shumë vite pas krijimit të nismës Adriatik-Jon mjedisi gjeopolitik rrethues ka ndryshuar ndjeshëm. Veçanërisht ndërmjet Vendeve Pjesëmarrëse të AII, Sllovenia në vitin 2004 dhe Kroacia në vitin 2013 u futën në BE ndërsa Vendet e tjera bregdetare në lindje të deteve Adriatik-Jon (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia) edhe pse me periudha dhe kushte të ndryshme gradualisht po ia afrohen BE-së brenda kuadrit të Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit, si një prelud për një anëtarësim të ardhshëm në BE. Pavarësisht nga këto ndryshime, arsyet e krijimit të AII ende qëndrojnë, dhe madje janë bërë edhe më të forta me kalimin e kohës.

Makrorajoni Adriatik-Jon

Detyra kryesore e Makrorajonit Adriatik- Jon është lidhja e territoreve që përfshihen në të për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të tyre dhe, në të njëjtën kohë, të mbrojtë mjedisin e brishtë detar, bregdetar, dhe tokësor.

Makrorajoni nuk është një rajon gjeografik me kufij të paracaktuar; ajo është një zonë funksionale, që përbëhet nga organe kombëtare, rajonale, lokale që bashkohen për të trajtuar një numër të përbashkët çështjesh dhe që përfshijn territore të Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Greqisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Sllovenisë.

Rrjeti Ekologjik Kombëtar si pjesë e Rrjetit Ekologjik Pan-Evropian (PEEN)

Rrjeti Ekologjik Pan-Evropian (PEEN) që buron nga Strategjia Pan-Evropiane për Biodiversitetin Biologjik dhe Peizazhor (PEBLDS) ka për qëllim të lidhë zona të ndryshme të mbrojtura kombëtare dhe evropiane dhe rrjetet ekologjike me synimin për të siguruar një status të favorshëm ruajtjeje të ekosistemeve, habitateve, llojeve dhe peizazheve kyç evropiane.

Shqipëria mori pjesë në projektin e realizuar nga Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës (ECNC) që për herë të parë

hartoi hartën Treguese të Rrjeti Ekologjik Pan-Evropian për Evropën Juglindore ku u identifikuan zonat kryesore natyrore me rëndësi evropiane, korridorët ekzistuese ndërmjet këtyre zonave, si edhe vendet ku mund dhe duhet të ngriheshin korridorët e reja. Sidoqoftë ky proces është ende në fazat e para të zbatimit në Shqipëri.

Zonat e Rëndësishme për Shpendët në Shqipëri

Sipas studimit “Inventari i ligatinave në Shqipëri”, i realizuar nga zyra e Qendrës Mjedisore për Administrim dhe Teknologji në Tiranë (QMAT) në bashkëpunim me EKBY Greqi, është bërë identifikimi i zonave të rëndësishme për shpendët në Shqipëri.

Gjithashtu është përgatitur statusi i tyre drejt përcaktimit si ZMV për shpendët, në përputhje me dispozitat e Direktivës për Shpendët, nëpërmjet përpunimit të kuadrit ligjor kombëtar me miratimin e Ligjit “Për mbrojtjen e faunës së egër” në fund të vitit 2008.

Procesi Smerald

Identifikimi i Zonave me Interes të Veçantë Ruajtjeje (ASCIs) u bë në periudhën 2002-2008 në Shqipëri. Si rezultat u identifikuan dhe studiuuan 25 zona potenciale Smerald. Procesi i vlerësimit nga Këshilli i Evropës ende vijon.

Strategjia e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR)²²

Kur po përgatitej ky raport, sapo kishte filluar një konsultim me publikun në lidhje me Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR).

Ky konsultim me publikun synonte përfshirjen e grupeve përkatëse të interesit dhe marrjen e ideve të tyre për të siguruar që Strategjia të jetë realiste që në fillim, të ketë objektivat e përshtatshme/ të duhura dhe t’u përgjigjet nevojave të vërteta të banorëve të Rajonit. Objektivi i përgjithshëm i EUSAIR-it është promovimi i mirëqenies së qëndrueshme ekonomike dhe sociale të rajonit, nëpërmjet rritjes dhe krijimit të vendeve të punës, duke përmirësuar natyrën e tij tërheqëse, shpirtin e konkurrencës dhe lidhjet e tij, dhe duke ruajtur njëkohësisht mjedisin dhe siguruar ekosisteme detare dhe bregdetare të shëndetshme dhe të ekuilibruara..

21 <http://www.aai-ps.org/>

22 http://ec.europa.eu/regional_policy/consultation/eusair/index_en.cfm

Pjesa III

Komente dhe rekomandime për zonat e mbrojtura detare në Shqipëri

Si u përmend më sipër, ZMD-ja e parë, Ishulli i Sazanit-Gadishulli i Karaburunit, u shpall në vitin 2010, me statusin e Parkut Kombëtar Detar (kategoria II e IUCN-së) dhe mbulon një sipërfaqe prej 12.570 ha. Shpallja e ZMD-së së parë duhet konsideruar si një hap para drejt fuqizimit dhe zgjerimit të sistemit të zonave të mbrojtura në Shqipëri, që është një nga objektivat më të rëndësishme të Programit të Punës dhe Planit të Veprimit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Brenda këtij kuadri synohet që zonat e mbrojtura do të mbulojnë rreth 20 % (aktualisht rreth 16 %) të sipërfaqes së përgjithshme të vendit si një objektivi afatgjatë.

I. KOMENTE DHE REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Komentet dhe rekomandimet e mëposhtme u nxorën nga analiza e kuadrit ligjor dhe institucional si edhe nga diskutimet që u bënë gjatë takimit kombëtar të punës të organizuar në korrik 2013 (Shikoni Shtojcën 2).

Shumë nga këto rekomandime për përmirësimin e kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional për ZMD-të si edhe në lidhje me disa prioritete të tjera të identifikuar nga vendi, mbështeten në parimet e përgjithshme të paraqitura në tri dokumente kryesore:

— *Udhëzime për Legjislacionin e Zonave të Mbrojtura* publikuar në vitin 2011 nga Qendra për të Drejtën Mjedisore e IUCN-së²³. Kryesisht Pjesa III, Kreu 2: Çështje të veçanta për zonat e mbrojtura detare.

— *Udhëzime për Zbatimin e Kategorive të IUCN-së të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura në Zonat e Mbrojtura Detare* publikuar në vitin 2012 nga IUCN-ja²⁴.

23 Lausche, Barbara. (2011). *Udhëzime për legjislacionin e zonave të mbrojtura*. IUCN, Gland, Zvicër. xxvi + 370 pp.

24 Day J., Dudley N., Hockings M., Holmes G., Laffoley D., Stolton S. & S. Wells, 2012. *Udhëzime për zbatimin e Kategorive të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura të IUCN-së në Zonat e Mbrojtura Detare*. Gland, Zvicër: IUCN. 36pp.

— *Udhëzuesi i Praktikave më të Mira për Njohjen e Zonave të Mbrojtura dhe Përcaktimin e Kategorive të Menaxhimit dhe Llojeve të Qeverisjes* publikuar në vitin 2013 nga IUCN WCPA²⁵.

Vetë këto parime mbështeten në përvojën e gjerë të IUCN-së në fushën e vlerësimeve të kuadrit ligjor dhe institucional të vendeve në lidhje me zonat e mbrojtura si edhe në përvojën dhe praktikën e mira kur zbatohen kategoritë e menaxhimit të IUCN-së dhe në analizën e modeleve të qeverisjes për ZM-të në përgjithësi dhe ZMD-të në veçanti.

Gjithashtu, në fillim të vitit 2009, duke pasur parasysh ngritjen e ZMD-së së parë në Shqipëri, Milieu Ltd. u kontraktua nga zyra e PNUD-it në Shqipëri për të realizuar vlerësimin e kuadrit ligjor për ZMD-të në Shqipëri me titull: “Raporti për Zonat e Mbrojtura Detare”. Kësisoj autorët rekomandojnë edhe leximin e këtij raporti dhe veçanërisht faqen 49 ku jepet përmbledhja e gjetjeve kryesore të këtij vlerësimi.

A. Legjislacioni, politika dhe planifikimi strategjik

Legjislacioni kombëtar me ombrellën e Ligjit për Zonat e Mbrojtura dhe Ligjin për Mbrojtjen e Biodiversitetit si edhe dokumenti strategjik që e shoqëron, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin, shtjellojnë çështjen e ZM-ve.

Përkufizimi ekzistues i zonës së mbrojtur në legjislacionin shqiptar sugjeron që zonat e mbrojtura mund të shpallen në zonat detare (Neni 3 (1)) i Ligjit Nr.8906 për zonat e mbrojtura; “Zona të Mbrojtura” shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore

25 Dudley, N. (Editor) (2008). *Udhëzime për zbatimin e Kategorive të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura*. Gland, Zvicër: IUCN. x + 86pp. Me Stolton, S., P. Shadie dhe N. Dudley (2013). *Udhëzuesi i IUCN WCPA i Praktikave më të Mira për Njohjen e Zonave të Mbrojtura dhe Përcaktimin e Kategorive të Menaxhimit dhe Llojeve të Qeverisjes*, Seria Nr. 21 e Praktikave më të Mira për Zonat e Mbrojtura, Gland, Zvicër: IUCN.

bashkëkohore". Sidoqoftë, legjislacioni shqiptar nuk përfshin një përkufizim të veçantë për ZMD-të.

Pjesëmarrësit në takimin kombëtar të punës, kur u pyetën për nevojën për të hartuar një ligj të posaçëm për ZMD-të, u përgjigjën se nuk kishte nevojë për një ligj të ri, përveç atij për Zonat e Mbrojtura, por që dekretet dhe urdhrat e Ministrisë përgjegjëse mund të merreshin parasysht për të zbatuar dhe kuptuar më mirë kuadrin ekzistues ligjor.

Kjo ide mbështetet nga fakti që në Shqipëri zbatimi i dispozitave të ligjeve ndiqet nga akte nënligjore që hartohen dhe plotësojnë bazën ligjore për elemente specifike të natyrës. Habitatet dhe llojet e mjedisit detar dhe bregdetar mund të jenë objektet e këtyre dokumenteve.

Kësisoj kuadri ligjor dhe strategjia kombëtare do të "ishin në harmoni me kërcënimet specifike, njohuritë shkencore dhe sfidat e menaxhimit që paraqesin ZMD-të", siç rekomandohet nga Udhëzimet e IUCN-së për Legjislacionin e Zonave të Mbrojtura.

"Në ditët e sotme, shkencëtarët dhe ekspertët e politikave e pranojnë që ZMD-të kërkojnë një konsideratë të veçantë ligjore për të trajtuar karakteristikat e tyre të dallueshme. Si përgjigje, shtetet po miratojnë gjithnjë e më shumë ligje që marrin parasysht sfidat e menaxhimit dhe ruajtjes së ekosistemit detar". Pra, "është e rëndësishme të bëhet rishikimi i aspekteve të mjedisit detar që paraqesin sfida të veçanta që duhen pasqyruar siç duhet në legjislacion". "Një numër karakteristikash të ekosistemeve detare i bëjnë ato qenësish të ndryshme nga sistemet tokësore. Këto ndryshime, është pranuar tani, kërkojnë trajtim të veçantë legjislativ që kuadri ligjor të jetë efektiv në mbështetjen e zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare."

E njëjta qasje duhet të zbatohet me politikën. Në të vërtetë:

"Politikat për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare mund të theksojnë qëllimet e përgjithshme si më poshtë:

- (a) Ngritja dhe mirëmbajtja e një rrjeti gjithëpërfshirës dhe përfaqësues zonash të mbrojtura detare dhe bregdetare me qëllim ruajtjen e të gjithë gamës së habitateve dhe ekosistemeve detare, duke i dhënë përparësi mbrojtjes së atyre që janë të rralla apo unike;*
- (b) Avancimi i rrjetit botëror të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare nëpërmjet veprimit kombëtar;*
- (c) Promovimi i bashkëpunimit rajonal në lidhje me burimet e përbashkëta detare dhe ekosistemet e rëndësishme detare;*
- (d) Sigurimi i mirëqenies së vazhdueshme sociale dhe ekonomike të njerëzve që ndikohen nga krijimi i zonave mbrojtura detare dhe bregdetare;*
- (e) Promovimi i përdorimit të një game të gjerë qasjesh qeverisëse për menaxhimin e ZMD-ve".*

(Udhëzimet e IUCN-së për Legjislacionin e Zonave të Mbrojtura)

Shqipëria është palë e një numri të konsiderueshëm të Marrëveshjeve Shumëpalëshe dhe Konventave Mjedisore (shikoni Shtojcën 1) që mund t'i shërbejë vendit si një mundësi

por edhe si detyrim për hartimin e ligjeve dhe politikave për krijimin dhe mbrojtjen e ZMD-ve.

Tashmë, një projekt i PNUD-it kohët e fundit ka hartuar një Plan Strategjik për Zonat e Mbrojtura Detare dhe Bregdetare, siç u përmend më parë në këtë dokument. Ky Plan Strategjik është në pritje të miratimit nga Qeveria.

Shqipëria duhet të sigurojë që sistemi i Zonave të Mbrojtura të përfshijë parimet e mëposhtme mjedisore ndërkombëtare:

- Parimin e parandalimit dhe marrjen e masave paraprake;
- Pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin ndaj informacionit;
- Njohjen e komuniteteve lokale;
- Vlerat kulturore.

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin, si detyrim i Konventës së Diversitetit Biologjik, është një hap pozitiv drejt harmonizimit me konventat ndërkombëtare. Progresi më i rëndësishëm i arritur është ai në lidhje me mbulimin e Zonave të Mbrojtura në vendin e cili u dyfishua brenda pesë viteve. Zonat e mbrojtura në vitin 2012 zinin rreth 15% të territorit të vendit. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin kishte propozuar tetë zona përgjatë bregdetit shqiptar si zona potenciale për t'u shpallur Zona të Mbrojtura Detare.

Procesi i aderimit të vendit në BE ka funksionuar gjithashtu si një shtysë e rëndësishme në harmonizimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe në mbrojtjen e llojeve të ndryshme të habitateve. Rrjeti Natura 2000 do të ofrojë mundësi të mëtejshme si edhe më shumë detyrime.

"Në vitin 2007, Komisioni i Komunitetit Evropian nxori udhëzime për mënyrën e zbatimit të Direktivave në lidhje me ZEE-të (Zonat Ekonomike Ekskluzive). Udhëzimet për ngritjen e rrjetit Natura 2000 në mjedisin detar (EC, 2007), përfshijnë diskutimin për zona të ndryshme detare, aspektet ligjore për zbatimin e legjislacionit mjedisor në mjedisin detar, llojet e habitateve detare, dhe si të lokalizojmë dhe përzgjedhim zonat e Natura 2000. Hartuesit ligjorë në Shtetet Anëtare të BE-së duhet t'i njohin këto udhëzime si sfond për formulimin e dispozitave ligjore për përcaktimin e ZMD-ve jashtë ZEE-ve të tyre për të qenë në përputhje me këto Direktiva." (Udhëzime për Legjislacionin e Zonave të Mbrojtura, IUCN)

Sipas Raportit të Katërt Kombëtar për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Diversitetin Biologjik (dhjetor 2010, për periudhën gusht 2007-dhjetor 2010), legjislacioni kombëtar shqiptar po përafrohet në mënyrë intensive me Direktivat e BE-së për mjedisin, meqë vendi është në procesin e aderimit në BE. Ajo është një shtysë për Shqipërinë në drejtim të mbrojtjes së mjedisit duke përmirësuar sistemin ligjor të saj dhe duke mbrojtur burimet natyrore të saj. Sfida më e madhe është kontrolli i zbatimit të ligjit dhe mekanizmat e tij që do të lejonin zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues në drejtim të ruajtjes dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare.

Gjithashtu, pjesëmarrësit në takim theksuan nevojën e fortë për më pak dublikim dhe më shumë harmonizim të kuadrit ligjor. Gjithashtu disa tekste janë përgjegjësi e parlamentit (ligji për mjedisin) apo përgjegjësi e ministrisë (peshkimi).

Sipas një raporti të shkruar nga Milieu Ltd për zyrën e PNUD-it në Shqipëri, *"pavarësisht nga kuadri ekzistues ligjor ndërkombëtar dhe evropian për ZMD-të, mbetet një sfidë për vendin ta përfshijë në ligjin dhe politikën e tij kombëtare"* (Raporti i Shqipërisë për ZMD-të, tetor 2009). Kjo deklaratë është ende e vërtetë edhe në vitin 2013.

Këto pengesa mund të bëjnë që Shqipëria të humbë shumë shpejt shumë nga vlerat e biodiversitetit dhe habitateve natyrore të saj, duke përfshirë edhe ato bregdetare dhe detare.

Për sa i përket instrumenteve të politikave, dhjetë vjet më parë u hartua strategjia për Turizmin. Pjesëmarrësit në takim e pranuan se tashmë ekziston nevoja për analizë të mëtejshme (boshllëqet, informacioni i disponueshëm) në veçanti në lidhje me ndikimin në ZMD-të.

B. Institucionet

Ndonëse është fuqizuar, MMPAU përballet me dy vështirësi kryesore: (1) personeli i pamjaftueshëm për të mbuluar ngarkesën e saj të punës gjithnjë në rritje, dhe (2) një popullatë që shpesh nuk e kupton se përse mbi veprimtaritë e saj vendosen kufizime të mbrojtjes së mjedisit.

Në të vërtetë, të gjithë pjesëmarrësit në takimin e punës ishin dakord që zbatimin e pjesës më të madhe të instrumenteve ndërkombëtare është përgjegjësi e MMPAU-t (përveç Ministrisë së Punëve të Jashtme). Sigurisht që ekziston nevoja për përforsimin e administratës dhe ekspertizës së Ministrisë për të përbushur të gjitha kërkesat e këtyre instrumenteve.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare

Gjatë seminarit, në disa raste QNOD-ja (IMOC), parashtrori gatishmërinë dhe kapacitetet e saj për të ndihmuar në lidhje me çështjet me të cilat përballen ZMD-të, veçanërisht me kontrollin e zbatimit të ligjit në det dhe monitorimin:

- QNOD-ja është e gatshme të mbështesë ZMD-të dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm meqenëse është përgjegjëse për sistemin e monitorimit të mjeteve lundruese (Kutia Blu). Ky sistem aktualisht do të financohet deri në vitin 2017 dhe do të zhvillohet nga sektori privat.
- Siç është përcaktuar tashmë, grupet e tjera të interesit nuk janë në dijeni të faktit që QNOD-ja ka kompetenca në lidhje me mjedisin detar, peshkimin dhe zbatimin e protokollit për Menaxhimin e Integruar të Zonave Bregdetare.
- Mund të ekzistojnë disa dublikime që duhen trajtuar, d.m.th. Mandatet e Rojave Bregdetare dhe të forcave të armatosura për vëzhgimin e detit.
- Për QNOD-në, kompetencat e MMPAU-t dhe të autoriteteve vendore janë të qarta për sa i përket mjedisit tokësor. Në anën tjetër, këto kompetenca janë më pak të qarta në lidhje me mjedisin detar: transportin detar, turizmin e zhvilluar në ZMD etj.

Prandaj, mekanizmat e ofruara për bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet agjencive qeveritare kryesore përgjegjëse për çështjet detare (p.sh. ruajtja e mjedisit detar, peshkimi, transporti me anije, dogana, etj.) duhet të përmirësohen. Prandaj rekomandohet hartimi i protokolleve të bashkëpunimit për ZMD-të.

C. Menaxhimi

Pjesëmarrësit në takimin kombëtar të punës pranuan që:

- Menaxhimi mund të delegohet por kjo do të thotë sistem i decentralizuar drejt niveleve rajonale/lokale. Deri tani kjo nuk ka ekzistuar. Decentralizimi është një alternativë që merret në shqyrtim por e pamundur për t'u zbatuar tani brenda kuadrit ligjor ekzistues: rrjedhimisht kërkohet një instrument i ri;
- Nga ana tjetër, ligji për peshkimin e pranon bashkëmenaxhimin;
- Duhet rritur efikasiteti i menaxhimit. Kush do ta menaxhojë mjedisin detar dhe bregdetar dhe në mënyrë më specifike ZMD-të, me një pyetje për ligjtinat që lidhen me detin? MMPAU u përgjigj që për ZM-të duhet një agjenci shtetërore me nënseksione si zona të mbrojtura detare, lagunore, bregdetare dhe tokësore.

Është e vërtetë që *"përvoja e menaxhimit me kategoritë e zonave të mbrojtura për mjediset detare është më pak e zhvilluar se sa për mjediset tokësore (...) ekspertët e pranojnë që ka më pak udhëzime dhe praktika të mira të disponueshme për mënyrën e vënies në zbatim të kategorive të zonave të mbrojtura sipas IUCN-së në sistemet detare për menaxhimin dhe rregullimin (...) në të shkuarën shumë menaxherë të ZM-ve ishin të mendimit që ZMD-të duhej t'i përkisnin kategorisë I, II, ose III. Teksa vendet përqipen të përbushin synimet globale dhe kombëtare për ZMD-të, komuniteti i ruajtjes po pranon nevojën në rritje për të përdorur të gjithë gamën e kategorive të menaxhimit të ZM-ve për të mbrojtur biodiversitetin detar."* (Udhëzime për Legjislacionin e Zonave të Mbrojtura, IUCN)

Pjesëmarrësit në takimin e punës informuan që nuk ka asnjë studim për Natura 2000. Ushtimi është duke u testuar për momentin. MMPAU është dakord që zonat e Natura 2000 të përdoren për shpalljen e zonave ndërkombëtare.

PNUD-i mendon se meqë Shqipëria ndodhet në një periudhë tranzitore në aderimin në BE, çështja e zonave të Natura 2000 është URGJENTE dhe që duhet hartuar një plan menaxhimi.

Prandaj rekomandohet që Shqipëria duhet të përdorë udhëzimet për të përcaktuar formatin e planeve të menaxhimit, procesin e rishikimit të tyre, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e të gjitha grupeve përkatëse të interesit, si edhe përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit të Menaxhimit, sipas kategorive të zonave të mbrojtura dhe specifikave të rajonit (veprimtaritë, ekosistemet, llojet, etj.)

Gjashtë kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri siç parashikohet në ligjin për zonat e mbrojtura mbështeten në kategoritë e menaxhimit të ZM-ve të IUCN-së. Por, ashtu siç theksohet në raportin e Milieu për ZMD-të, *"përshkrimi i zonave dhe niveli përkatës i mbrojtjes janë formuluar me një fokus të madh mbi tokën"*. Në këtë mënyrë, menaxhimi i ZMD-ve do të përfitonte nga një riformulim në instrumentet ligjore i përkufizimeve, objektivave të ZM-ve dhe llojeve të veprimtarive të ndaluara (niveli i mbrojtjes).

Gjithashtu, menaxhimi i ZMD-ve mund të plotësohet nga legjislacioni ekzistues që rregullon veprimtaritë e peshkimit (monitorimi dhe kontrolli, menaxhimi i përbashkët i komuniteteve

të peshkimit, masat minimale të mbrojtjes, lejet e peshkimit, etj.)

D. Qasja e shumë grupeve të interesit

Neni 13.1 i vitit 2002 i Ligjit për Zonat e Mbrojtura parashikon qasjen pjesëmarrëse në shpalljen e një zone të mbrojtur, dhe Ligji për Mbrojtjen e Biodiversitetit shtjellon më tej rëndësinë e pjesëmarrjes. Qasja pjesëmarrëse do të ishte e nevojshme edhe në proceset e menaxhimit dhe planifikimit (d.m.th. zonimit).

Pjesëmarrja e publikut dhe qasja e shumë grupeve të interesit është një pjesë shumë e rëndësishme e qeverisjes mjedisore. Në periudhën afatgjatë, rritja e ndërgjegjësimit mjedisor ka dëshmuar të jetë një hap shumë pozitiv në ruajtjen e natyrës dhe mjedisit detar në Shqipëri, me përfshirjen e llojeve të tjera të grupeve të interesuara përveç atyre qeveritare, duke ndarë dhe komunikuar ndërmjet tyre kësajsoj përvojën dhe njohuritë ekzistuese në lidhje me çështjet e menaxhimit. Kështu, nuk ka dyshim që një pjesëmarrje më e madhe e të gjitha grupeve të interesit të ZMD-ve do të jetë pozitive në zgjidhjen e konfliktit të interesit për shembull.

Gjithashtu, *“në dallim të madh me shumicën e çështjeve të zonave të mbrojtura tokësore, institutet e ndryshme me interesa dhe veprimtari në mjedisin detar nuk kanë traditë bashkërendimi apo kanë një perceptim të vogël për nevojën për bashkëpunim, (...) disa mandate janë vjetruar, apo mbivendosen, konkurrojnë apo krijojnë boshllëqe dhe pasiguri në lidhje me faktin se cila agjenci do të marrë drejtimin. Kjo e bën edhe më kritike nevojën e mekanizmave institucionalë për bashkëpunim dhe bashkërendim të çështjeve që kanë të bëjnë me ZMD-të”*. (Udhëzime për Legjislacionin e Zonave të Mbrojtura, IUCN)

Në bazë të statusit dhe rolit të organizatave ekologjike jo-qeveritare përkatëse, Shqipëria mund të zgjedhë të nxisë veprimtaritë e tyre dhe t'i mbështesë ato duke ofruar elementet e nevojshme për realizimin e objektivave të mbrojtjes së mjedisit.

Në Shqipëri, bashkëmenaxhimi i ZM-ve nuk ekziston. Kësajsoj, një rekomandim do të ishte marrja në shqyrtim e alternativave shtesë për delegimin e menaxhimit (OJF-ve, sektorit privat, komuniteteve vendase) apo bashkëmenaxhimi ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë si modele të reja të qeverisjes.

Në të vërtetë, pjesëmarrësit në takim e pranuan që qasja pjesëmarrëse ende nuk është pjesë e kulturës në Shqipëri ku vendimmarrja është shumë e centralizuar.

Ky studim, duke ndjekur një qasje institucionale nuk e përfshiu sektorin privat në analizën e grupeve të interesit. Prandaj rekomandohet që të zhvillohet një analizë të hollësishme e grupeve të interesit të sektorit privat.

II. KOMENTE DHE REKOMANDIME TË VEÇANTA

Gjatë takimit kombëtar të punës, pjesëmarrësit i kërkuan IUCN-Med të fokusohet në disa çështje specifike kur të përpilojnë rekomandimet e këtij studimi: SKPVB-ja; procesi i VNM-së; burimet e financimit të ZMD-ve.

A. SKPVB-ja

Në rast se Shqipëria dëshiron të rishikojë SKPVB-në e saj, rekomandimet e mëposhtme do të jepeshin për të mbështetur vendin në zbatimin e synimit të Aichi-t :

— Ngritja e një seksioni të veçantë për mjedisin detar duke përfshirë marrjen parasysh të biodiversitetit detar (flora: algat dhe barin e detit; fauna: llojet bentike dhe pelagjike me vëmendje të veçantë tek peshqit, breshkat e detit, gjitarët e detit dhe shpendët e detit), veprimtaritë detare (turizmi, peshkimi, ndotja, trafiku, të tjera), planifikimi hapësinor detar në lidhje me planifikimin e përdorimit të tokës (në kontekstin e menaxhimit të integruar të zonave bregdetare) dhe menaxhimi (duke përfshirë në veçanti ZMD-të dhe rezervatet e peshkimit).

— Duke u mbështetur në këtë seksion, të bëhet identifikimi i nevojave për përmirësimin e legjislacionit dhe mekanizmat përkatës institucionalë për të menaxhuar më mirë mjedisin detar dhe bregdetar nëpërmjet një bashkërendimi dhe bashkëpunimi rigoroz ndërmjet administratave përkatëse të zonave detare dhe tokësore.

Në lidhje me ZMD-të, një nga rekomandimet do të ishte hartimi i strategjisë kombëtare për zonat e mbrojtura detare (identifikimi, përzgjedhja, shpallja dhe menaxhimi i zonave detare dhe ruajtja e biodiversitetit detar) duke përfshirë rezervatet e peshkimit dhe listën e kuqe.

B. A nevojitet një VNM dhe VSM për shpalljen e ZMD-së?

Gjatë takimit të punës, MMPAU informoi që për zhvillimin e çdo veprimtarie publike apo private në ZM (rrjedhimisht edhe në ZMD) duhet bërë një VNM (dekret i ri) dhe përfaqësuesit e PNUD-it e pranuan që kjo do të merrej parasysh nga analiza e boshllëqeve e realizuar nga PNUD-i duke ditur që Ligji për ZM-të nuk është i qartë sa duhet në lidhje me këtë pikë.

Një vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) është vlerësimi i ndikimeve të mundshme që një projekt i propozuar mund të ketë mbi mjedisin, që përbëhet nga aspektet mjedisore, sociale dhe ekonomike. Qëllimi i vlerësimit është të sigurojë që vendimmarrësit të marrin parasysh ndikimet (mjedisore, sociale dhe ekonomike) kur vendosin të procedojnë me një projekt apo jo.

Përkufizimi : *“procesi i identifikimit, parashikimit, vlerësimit dhe zbutjes së efekteve biofizike, sociale, ekonomike dhe efekteve të tjera përkatëse të propozimeve për zhvillim/ndërtim para marrjes së vendimeve dhe angazhimeve madhore”*.

VNM-të janë unike sepse ato nuk kërkojnë respektimin e një rezultati mjedisor të paracaktuar, përkundrazi ato u kërkojnë vendimmarrësve të marrin parasysh vlerat mjedisore në vendimet e tyre dhe t'i përligjin ato vendime në këndvështrimin e studimeve të hollësishme mjedisore dhe pjesëmarrjes dhe komenteve të publikut në lidhje me ndikimet e mundshme në mjedis.

Një vlerësim strategjik mjedisor (VSM) është procesi sistematik i mbështetjes së vendimeve, që ka për qëllim të sigurojë shqyrtimin me efektivitet të aspekteve mjedisore dhe mundësisht të aspekteve të tjera të qëndrueshmërisë në hartimin e politikave, planeve dhe programeve.

Në këtë kontekst, sipas Fischer (2007), VSM-ja mund të shihet si:

- një proces i strukturuar, rigoroz, pjesëmarrës, i hapur dhe transparent, i mbështetur në VNM, i zbatuar veçanërisht për politikën, planet dhe programet e hartuara nga autoritetet publike të planifikimit dhe me raste edhe nga organe private,
- një proces pjesëmarrës, i hapur dhe transparent, mundësisht jo i mbështetur në VNM, i zbatuar me më shumë fleksibilitet për politikën e hartuara nga autoritetet publike të planifikimit dhe me raste edhe nga organe private, ose
- një proces fleksibël, që nuk mbështetet në VNM, i cili zbatohet për propozime legjislativë dhe politika, plane dhe program të tjera në vendimmarrjen politike/të kabinetit qeveritar.

Një VSM efektiv funksionon brenda një kuadri vendimmarrjeje të strukturuar dhe përshkallëzuar, duke synuar mbështetjen e vendimmarrjes më efektive dhe efikase për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet një fokusi të konsiderueshëm në temat, çështjet dhe alternativat për t'u shqyrtuar gjatë hartimit të politikave, planeve dhe programeve. VSM-ja është një instrument që mbështetet në prova, që ka për qëllim t'i shtojë rigorozitet shkencor hartimit të politikave, planeve dhe programeve, nëpërmjet përdorimit të metodave dhe teknikave të përshtatshme vlerësuese.

Duke u mbështetur në këto dy përkufizime, një instrument ligjor, një strategji apo politikë kombëtare për ZMD-të ka nevojë për një VSM nga qeveria ndërsa shpallja e një ZMD-je individuale ka nevojë për një VNM me pjesëmarrje të madhe të publikut.

C. Burimet e financimit të ZMD-ve

(shikoni gjithashtu edhe Shtojca IV)

Gjatë takimit të punës, ekipi i PNUD-it theksoi që meqë Shqipëria ndodhet në një periudhë tranzitore në aderimin në BE, çështja e zonave të Natura 2000 është URGJENTE dhe që duhet hartuar një plan menaxhimi, duke shtuar që mund të jetë një burim i financimeve të BE-së.

Në përgjithësi, në lidhje me burimet e financimit për ZMD-të:

- PNUD-i vërejtë që “nuk ekziston asnjë dispozitë në ligj për financimin e zbatimit. Është hartuar një draft përfundimtar për Fondin Mjedisor por procesi është bllokuar për shkak të mungesës së konsensusit politik”.
- MMPAU informoi se “gjobat mblidhen në nivel lokal dhe pastaj shkojnë në buxhetin qendror”.
- INCA (një nga OJF-të kryesore) shtoi se “donatorët financojnë në Zonat e Mbrojtura me prioritet por rezultatet janë të kufizuara, shikoni shembullin e Liqenit të Prespës”.

Kuadri ligjor për ZM-të në Shqipëri qartësisht ka nevojë për përmirësime në drejtim të instrumenteve financuese për ZMD-të. Duhet të zbatohet një sistem i përshtatshëm për të mbuluar të paktën pjesë të nevojave bazë si kontrolli i zbatimit dhe monitorimit. Një rekomandim do të ishte marrja parasysh e FM-së apo FMM-së.

Burimet e financimit, në veçanti fondet mjedisore mund të vijnë nga burimet e mëposhtme:

- Shumat e alokuara nga buxheti i shtetit për të subvencionuar Fondin Mjedisor.
- Grantet dhe donacionet e organizatave kombëtare dhe të huaja për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit.
- Gjobat e vendosura dhe kompensimi ligjor apo i dakortësuar për dëmet që i shkaktohen mjedisit.
- Taksat e vendosura mbi biletat e fluturimeve ajrore apo vizave (apo një përqindje e tyre) në lëshuara në vend.
- Të ardhurat financiare nga realizimi i projekteve eksperimentale.
- Shumat e mbledhura për shërbimet që u ofrohen palëve të treta.
- Tarifat e lejeve të lëshuara nga Ministria për veprimtaritë brenda zonave të mbrojtura.

Një publikim shumë i dobishëm për një vështrim të përgjithshëm të mundësive për të financuar një zonë të mbrojtur është Financimi i Ruajtjes së Zonave të Mbrojtura në Karaibe: Një Udhëzues për Menaxherët dhe Organizatat e Ruajtjes nga Ruth Norris²⁶.

Tabela në seksionin III faqet 18 - 22 ofron një vështrim skematik të mundësive, me komente për avantazhet, disavantazhet dhe rrethanat në të cilat secila nga mundësitë është më e dobishme dhe e përshtatshme.

Një alternativë tjetër për t'u marrë parasysh lidhet me potencialet e tregut të karbonit në të ardhmen.

Çfarë është një fond mjedisor apo një fond për mbrojtjen e mjedisit?

Një Fond Mjedisor (FM) apo një Fond për Mbrojtjen e Mjedisit (FMM) është një fond i krijuar me ligj në një vend. Qëllimi i tij është nxitja e investimeve në sektorin e mjedisit për të mbështetur politikën qeveritare mjedisore, sociale dhe ekonomike. Për të realizuar këtë qëllim, FMM-ja ofron asistencë financiare në një bazë konkurruese për projektet që i sjellin përfitime mjedisit. Gjithashtu, FMM-ja kërkon të promovojë partneritete ndërmjet komunitetit financiar dhe sektorëve publikë dhe privatë për të rritur investimet në mbështetje të nismave mjedisore. **Objekti:** Ofrimi i asistencës financiare për zbatimin e projekteve mjedisore në përputhje me ligjet mjedisore. **Vizioni:** Nxitja e investimeve në sektorin e mjedisit duke mbështetur politikën mjedisore, sociale dhe ekonomike për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Për të realizuar përmirësimin e mjedisit, duhet të ndërmerren investime të konsiderueshme në sektorin e mjedisit. Investimet nevojiten jo vetëm në fushën e kontrollit të ndotjes, por edhe në zhvillimin e teknologjisë miqësore ndaj mjedisit, ofrimin e shërbimeve mjedisore dhe ngritjes së sistemeve të sigurta mjedisore. Kjo fushë investimesh ka sjellë një instrument novator financiar për të nxitur investimet në mjedis.

26 [http://cep.unep.org/issues/Funding\(E\)-final.pdf](http://cep.unep.org/issues/Funding(E)-final.pdf)

Shtojca I:

Konventat ndërkombëtare dhe Marrëveshjet Shumëpalëshe të ratifikuara nga Shqipëria me interes për Zonat e Mbrojtura Detare

Nivel ndërkombëtar	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit, Gjiri i Montegos, 10 dhjetor 1982.	Hyrë në fuqi, më 6 nëntor 1994, ratifikuar më 23 qershor 2003
	Konventa për Diversitetin/Larminë Biologjike Rio de Zhaneiro, 5 qershor 1992, hyrë në fuqi më: 29 dhjetor 1993	Shqipëria është palë e KDB-së që nga 5 janari i viti 1994 dhe e ka ratifikuar më 10.11.1996
	Konventa për Ligatinat të Rëndësisë Ndërkombëtare Veçanërisht si Habitat i Shpendëve të Ujit (Ramsar)	Hyrë në fuqi për Shqipërinë më 29 shkurt 1996
	Konventa për Trashëgiminë Botërore	Ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1979
	Konventa për të drejtën e publikut për Informacion, për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar Gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin" (Aarhus,1998)	Ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2000
	Konventa CITES për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (Uashington, D.C., më 3 mars 1973, ndryshuar në Bon më 22 qershor 1979)	Nënshkruar nga Shqipëria më 27 qershor 2003
	Konventa ESPOO (Finlandë) "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar."	Shqipëria e ratifikoi konventën më 4 tetor 1991. Më pas Shqipëria ratifikoi edhe amendamentet dhe protokollin.

© Gérard Pergent.





© RAC/SPA, University of Sevilla.

Nivel rajonal	Konventa "Për Ruajtjen e Faunës së Egër dhe Habiteteve Natyrore Evropiane" (Konventa e Bernës)	Ratifikuar nga Parlamenti me ligjin "Për ratifikimin e "Konventës për ruajtjen e faunës së egër dhe habiteteve natyrore evropiane (Konventa e Bernës); e botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 7, datë 4.4.1998 (faqe 251)
	Konventa "Për ruajtjen e llojeve shtegtare të faunës së egër" (Konventa e Bonit) dhe Marrëveshjet e saj për Cetacetë (ACCOBAMS), Popullatat evropiane të lakuriqëve të natës (Eurobats) dhe ruajtjes së shpendëve Afro-Aziatikë Shtegtarë të Ujit (AEWA)	Shqipëria ka aderuar në këtë konventë me ligjin Nr. 8692, datë 16.11.2000 "Për aderimin e Shqipërisë në Konventën e Bonit "Për ruajtjen e e llojeve shtegtare të faunës së egër " dhe marrëveshjet e kësaj Konvente, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 43, datë 13.11.2000 (faqe 1936)
	Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja (Barcelonë 1976)	<p>Nënshkrimi nga Shqipëria më 30 maj 1990 dhe amendamentet u pranuan më 26 korrik 2001. Protokollin për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura u ratifikua më 30 maj 1990 dhe Protokollin për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura dhe Biodiversitetin u ratifikua më 26 korrik 2001.</p> <p>Gjithashtu, protokollet dhe planet e veprimit të mëposhtme janë ratifikuar nga Shqipëria:</p> <ul style="list-style-type: none"> — Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Zonave Bregdetare të Detit Mesdhe (Plani i Veprimit për Mesdheun ose MAP Faza II). Miratuar më: 10 qershor 1995 (Barcelonë, Spanjë) – që zëvendësoi Planin e Veprimit për Mesdheun (MAP) të miratuar në vitin 1975. — Protokollin për Parandalimin dhe Eliminimin e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Shkarkimet e Anijeve dhe Avionëve ose Djegia në Det. Miratuar më 10 qershor 1995 (Barcelonë, Spanjë). — Protokollin për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Burimet dhe Veprimtaritë e Vendosura në Tokë. Miratuar më: 7 Mars 1996 (Sirakuzë, Itali). — Protokollin për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja që shkaktohet nga eksplorimi dhe shfrytëzimi i shelfit kontinental, i shtratit të detit dhe i nëntokës së tij. Miratuar më: 14 tetor 1994 (Madrid, Spanjë). — Protokollin për Parandalimin e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Lëvizjet Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Depozitimi i tyre (Protokollin i Mbetjeve të Rrezikshme) Miratuar më: 1 tetor 1996 (Izmir, Turqi).

Shtojca II:

Report of the National Workshop on MPAs held in Tirana, Albania on July 2013 (available in English only)

The following is an extract of the “Report of the national consultation regarding Priority needs for legal, policy and institutional reforms to strengthen the creation processes and the management of marine protected areas in Eastern Adriatic”, issued in September 2013.

CONTEXT

In the framework of the activity entitled “Assessment and support to Adriatic countries’ priority needs for legal, policy and institutional reforms to strengthen the creation processes and the management of marine protected areas” of the the MedMPAnet Project – Regional Project for the Development of a Mediterranean Marine and Coastal Protected Areas (MPAs) Network through the boosting of MPA Creation and Management (<http://medmpanet.rac-spa.org/>), the Regional Activity Centre for Specially Protected Areas (UNEP/MAP – RAC/SPA) and the Center for Mediterranean Cooperation of the International Union for the Conservation of Nature (IUCN-Med) organized national workshops on MPAs legal and institutional frameworks in Albania, Croatia and Montenegro.

According to the objectives set, national consultation should have been conducted also in Bosnia and Herzegovina but could not take place for the reasons communicated by IUCN-Med to RAC/SPA.

Those events were held in the different countries at the following dates:

For Albania: preparatory meeting in Tirana on April 2012 and review meeting in Tirana on July 2013

OBJECTIVE

The objective of those workshops was to review with national stakeholders, experts and NGOs the findings of the study conducted in the countries concerning the assessment of the Legal, Policy and Institutional Framework for MPAs, then to examine options for improving the declaration and management of marine protected areas, including participatory mechanisms.

Outputs of the national consultations carried out in the countries by mean of those workshops will be used to finalize the more comprehensive country reports expected at the end of November 2013: “ALBANIA AND MARINE PROTECTED AREAS: Legal and Institutional framework assessment for conservation of coastal and marine biodiversity and the establishment of MPAs”

PARTICIPANTS

Representatives of the relevant ministries and of the national environmental agencies, MPA managers and public institutions in charge of MPA management (and if not specific to MPA, Protected Area), relevant bilateral or multilateral programme agencies, research institutes and academics, relevant NGOs and experts were invited. The three workshops were able to gather fifty two persons (see attendance lists below).

In Albania (47 invitations/24 participants):

1. Fatos Bundo, Ministry of Environment, Forest and Water Administration (MoEFWA)
2. Nihat Dragoti, Ministry of Environment, Forest and Water Administration (MoEFWA)
3. Elvana Ramaj, Ministry of Environment, Forest and Water Administration (MoEFWA)
4. Elvita Kabashi, The United Nations Development Programme (UNDP) in Albania
5. Violeta Zuna, The United Nations Development Programme (UNDP) in Albania
6. Eno Dodbiba, The United Nations Development Programme (UNDP) in Albania
7. Astrit Aliaj, Interministerial Maritime Operation Center (IMOC/QNOD), Durrës
8. Shefqet Bruka, Administrative Director, Interministerial Maritime Operation Center (IMOC/QNOD), Durrës

9. Arjan Cinari, Fishery Management Organization, Shkoder
10. Kujtim Onuzi, Albanian Geological Survey
11. Zamir Dedej, Institute of Nature Protection in Albania – INCA
12. Genti Kromidha, Institute of Nature Protection in Albania – INCA
13. Mirjan Topi, Protection and Preservation of Natural Environment in Albania (PPNEA)
14. Andrea Ghiurghi, IUCN Programme for South-Eastern Europe, Albania
15. Roland Kristo, Agriculture University, Fishery expert
16. Ermira Koçu-Deçka, Legal expert, Conservation and Sustainable Use of Biodiversity at Lakes Prespa, Ohrid and Shkodra/Skadar, National Coordinator, GIZ
17. Doreid Petoshati, UNDP MPA project, Vlore
18. Klodiana Gorica, University of Tirana, Faculty of Economy, Deputy Dean, Specialist in Tourism
19. Rigers Bakiu, Agricultural University of Tirana

The following participants indicated their willingness to join the meeting but were unable to attend.

20. Franka Paloka, Institute for Sustainable Development
21. Regional Environmental Center (REC)
22. Arduen Karagjozi, MoEFWA
23. Denis Grabocka, MoEFWA
24. Gezim Musabelli, MoEFWA

Note for Albania: Due to general elections, it proved difficult to mobilize all key national stakeholders to review the findings of the study or even to participate to a national workshop. Although the SPA National Focal Point in Albania, Mr Pellumb Abeshi, of MoEFWA, answered positively to IUCN-Med request to organize a national workshop on MPAs, he did not attend personally the meeting, proposing the event to take place within the first ten days of July and designating INCA (national NGO, member of IUCN) as the focal point for the organization of the event.

AGENDAS

Each workshop lasted one day. All workshops followed the same general agenda. Topics covered during the workshops concerned:

1. The state of the art of the legal and policy framework as well as the institutional arrangements for MPAs
2. The existing system for stakeholders participation in the identification, establishment and management of MPAs
3. The presentation of a general stakeholder participation toolkit
4. A priority needs diagnosis and options for improvement.

The time dedicated to each topic during the day was adapted to each country necessity (for example, in Croatia, participants didn't feel the need to spend much time on stakeholder participation toolkit while in Montenegro, consultation process being more advanced, much effort was dedicated to the Priority needs diagnosis).

See Agenda of the workshop hereafter.

Agenda Albania, Tirana, 10 July 2013
09:30 - 09:45 Registration of participants
09:45 - 10:00 Opening: Presentation of the study and objectives of the workshop
10:00 - 10:30 Session 1 : Findings of the study (state of the art)
10:45 - 11:15 Questions and discussion
11:15 - 11:45 Coffee break
11:45 - 12:45 Session 2: Priority needs diagnosis
12:45 - 13:30 Questions and discussion
13:30 - 14:30 Lunch
14:30 - 15:15 Session 2: Recommendations on Priority needs diagnosis
15:15 - 16:00 Session 3: Stakeholder participation toolkit
16:00 - 16:20 Coffee Break
16:20 - 17:30 Conclusions
17:30 - 17:45 Closure of the workshop

CONTENTS

The workshops were all facilitated by IUCN-Med, Alain Jeudy de Grissac.

Presentations were done which summarized the findings of the first phase of the study. The first phase was basically a bibliographical research and brief analysis based on legal documents in order to draft a state-of-the art. Those findings had previously been sent for revision to all countries' National Focal Points for SPA (in Albania: the General Director of Environmental Policies, Ministry of Environment, Forest and Water Administration) and some key national stakeholders (other governmental agencies and NGOs).

The following three working documents were distributed to the participants prior to all meetings for comments and review:

- Legal and Institutional country assessment for MPAs;
- Matrix summarizing the existing framework and identifying priority needs to improve the establishment and management of MPAs;
- General Stakeholder Participation Toolkit.

COMMENTS OF WORKSHOPS' PARTICIPANTS TO THE WORKING DOCUMENTS

In Albania:

The following general comments were done by the participants during the workshops:

In general regarding the document presented by IUCN-Med (legal and institutional frameworks for MPAs in Albania): the description of specific instruments such as the law on fisheries or the law on biodiversity protection needs to be improved as well as the description of the main administrations such as fisheries, tourism and maritime traffic.

There are some projects for marine areas, draft strategy for MPAs under preparation, not adopted, but could be only technical document for reference

UNDP manages a project on MPAs, apparently another report has been produced by a Belgium expert on shortcoming on MPAs, could be on internet site of UNDP

As it is a RAC/SPA initiative, recommendations could be done by the experts attending the meeting, then transferred to SPA focal point, then MPA focal point and (Barcelona Convention) and funding could be identified for assistance on the legal and institutional improvement related to MPAs. Other option is to review simply the documents and to propose improvement on gaps weaknesses and strength and let the government consider the proposals

Law on Fisheries (and aquaculture 64-2012) includes the decision 400/22 concerning the implementation of the EU decision of 2006 and in particular the control system on IUU (unreported and unregulated fishing).

Based on Law 64-2012, fisheries protected areas could be defined in the future and activities could be limited or prohibited.

MoEFWA: law on protected areas includes zoning and sub-zoning

Law for integrated management of waters 111/2012 in line with EU requirements

There is a strong need for less duplication and more harmonization of the legal framework. In addition some texts are the responsibility of the parliament (environmental law) or the responsibility of a ministry (fisheries)

All legal instruments need enforcement at all levels in the matter of MPAs and marine conservation, IMOC is very important as it includes the vessel monitoring system as an option

IMOC: important for MPAs, marine environment, fisheries and ICZM

IMOC: do they have or can they have a role? Yes, but some duplications have to be identified with the coast guards mandate or the armed force (navy or terrestrial mandates)

IMOC is available to support MPAs. It is a recently established institution thus other governmental institutions maybe aren't really aware of its competencies or of the role it could play. For IMOC, the competence of the MoEFWA+ local authorities

is clear as far as land is concerned whereas regarding marine environment it isn't as clear: e.g. maritime transport? Tourism in marine environment? MPAs?

IMOC blue box (vessel monitoring system) is financed until 2017 and developed with a private company

10 years ago, the national strategy for tourism was drafted. There's need for analysis, information is lacking, in particular on tourism in and around MPAs

2011 NPE: the law needs improvement on wildlife Ilojes and Natura 2000, in line with progress of the EU process

Nature protection agency +Department of legislation + Research institute (for biological research) are preparing proposals for PAs or MPAs that will be delivered to the council of ministers for decision.

A national strategy for protected areas has been partly drafted and reviewed (objective 2020 could be approved soon)

The national plan in relation with the integration of Albania in EU will include short and long term goals for MPAs, the strategic paper (produced in the framework of UNDP project includes 8 new MPAs)

When describing PPNEA: list the departments and their functions and indicate the committee of management for protected areas

Efficiency of management needs to be increased. Who will manage the coastal and marine and more specifically the MPAs, with a question on the wetlands connected to the sea?

MoEFWA: a state agency could be needed for PA with subsections such as marine, lagoon, coastal and terrestrial.

IMOC: no maps, no regulation documents, lack of awareness in particular the movements of boats in MPAs. Safety is also the responsibility of IMOC and there is a problem of competence on the sea to clarify, in particular with the ministry of tourism

